Funded by
the European Union

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT STUDIMOR

PËR MONITORIMIN E NDIKIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE NË PESË GJYKATA GJATË PERIUDHËS 2020-2024

PUBLIKUAR NË PRILL 2026

RAPORT STUDIMOR

PËR MONITORIMIN E NDIKIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE NË PESË GJYKATA GJATË PERIUDHËS 2020-2024

Publikuar në Prill 2026



Hartimi i këtij raporti realizohet në kuadër të nismës “Shoqëria Civile kundër korrupsionit nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Qëndrimet, opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk konsiderohen se reflektojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Përgatiti:
Znj. Blerina Bulica, Eksperte Ligjore, KShH

Rishikoi:
Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
Z. Njazi Jaho, Ekspert Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

TABELA E LËNDËS

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje 5
Përmbledhje Ekzekutive 8
2. Metodologjia 11
3. Vështrim historik i reformës për rishikimin e hartës gjyqësore 14
4. Vështrim mbi situatën në sistemin gjyqësor gjatë viteve 2018-2024 17
5. Monitorimi i zbatimit të hartës gjyqësore (2022-2024) 18
5.1 Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë 19
5.2 Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Fier 20
5.3 Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë 21
5.4 Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë 22
5.5 Gjykata Administrative e shkallës së parë Lushnje 23
6. Analiza e gjetjeve për të dyja periudhat: para miratimit të hartës (2020-2022) dhe pas (2023-2024) 24
7. Rekomandime 33
ANEKS 1 35
ANEKS 2 38

LISTA E SHKURTIMEVE

KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KLGj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MD	Ministria e Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë të Prokurorisë
JP	Juridiksioni i Përgjithshëm
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
NL	Norma e Likuidimit
KD	Koha e Disponimit
KEED	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
SIMC	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve
IT	Information Technology
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
IEVP	Institucione për Ekzekutimin e Vendimeve Penale
Stok Gjyqësor	Raste të mbetura pezull / Raste të prapambetura
Vetingu	Procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve

1. Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), si një organizatë e shoqërisë civile e përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e sundimit të ligjit në Shqipëri, ka ndërmarrë këtë studim monitorimi, për të vlerësuar në mënyrë të pavarur ndikimin real të reformës për rishikimin e hartës gjyqësore, mbi të drejtat themelore të qytetarëve dhe aksesin në drejtësi.

Ky vlerësim kritik përfaqëson angazhimin e shoqërisë civile për të evidentuar përgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë, duke siguruar që reformat gjyqësore t'i shërbejnë mbrojtjes së interesit publik për garantimin e të drejtave themelore të njeriut, si e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e pandashme të së cilës është edhe akses në drejtësi, si kusht parësor për administrimin efikas gjyqësor. KShH është i ndërgjegjshëm se reformat gjyqësore të kësaj shkalle kërkojnë mbikëqyrje të pavarur dhe rigoroze përtej vetëvlerësimit të institucioneve përgjegjëse të sistemit të drejtësisë.

Riorganizimi i sistemit gjyqësor të Shqipërisë në 20 gjykata përfaqëson një transformim të thellë në sistemin gjyqësor, duke ndikuar drejtpërdrejt në aksesin në drejtësi të afro tre milionë shtetasve shqiptarë. Për rrjedhojë, një ristrukturim i tillë kërkon vlerësim transparent dhe të bazuar në studime konkrete për të siguruar që rezultatet e reformës të përputhen me parimet demokratike dhe angazhimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe Konventave të tjera ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut e veçanërisht të drejtën për një proces të rregullt, ku shteti ynë ka aderuar.

Përmes mbledhjes së të dhënave gjyqësore dhe analizës sistematike të performancës së pesë gjykatave me ngarkesën më të lartë dhe të prekura nga harta gjyqësore për periudhën 2020-2024, ky studim siguron një vlerësim të pavarur të ndikimit të hartës, përkatësisht tek: gjykatat e rrethit (Tiranë dhe Fier), gjykata e apelit e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe gjykatat administrative (Tiranë dhe Lushnjë).

Ky studim kombinon analizën sasiore të performancës të gjykatave me vlerësimin cilësor të kuadrit ligjor, për të dalë me gjetje konkrete mbi efektin që krijojnë reforma të kësaj natyre në performancën e gjykatave dhe ndikimin tek të drejtat e njeriut. Në këtë analizë i jepet përparësi ndikimit që harta ka patur tek aksesi në drejtësi i qytetarëve, veçanërisht për popullatat në zonat rurale dhe periferike. Si rezultat i kësaj analize, janë evidentuar disa problematika sistematike që kanë ardhur si pasojë e efekteve të ardhura drejtpërdrejt nga zbatimi i hartës së re gjyqësore, dhe që kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve.

Ky raport shërben si kontribut i shoqërisë civile për të informuar debatin publik mbi efektivitetin e reformës gjyqësore, duke synuar që të ndikojë pozitivisht në ideimin e hartës së re gjyqësore, për të siguruar që sistemi gjyqësor i Shqipërisë t'i shërbejë sa më mirë të drejtave themelore njeriut.

Fjala Përshëndetëse e znj. Erida Skëndaj (Drejtore Ekzekutive e KShH-së), në tryezën teknike për konsultimin e këtij raporti me aktorë të sistemit të drejtësisë, në dt.20 Shkurt 2026

I nderuar Ministër i Drejtësisë,

I nderuar Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor,

E dashur Cinzia,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të Komitetit Shqiptar të Helsinkit si organizatorë të kësaj tryeze, ju falënderoj për praninë dhe gatishmërinë tuaj për të marrë pjesë në këtë diskutim.

Komiteti i Helsinkit ka dhënë kontributin e tij modest, në konsultimin e reformës në sistemin e drejtësisë, por edhe në monitorimin e zbatimit të kësaj reforme, duke synar gjithmonë një dialog konstruktiv dhe të hapur me institucionet dhe organet e drejtësisë, edhe atëherë kur raportet tona kritike nuk janë pranuar pozitivisht.

KShH ka qenë një nga organizatat që ka vendosur në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, bashkë me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për kundërshtimin e hartës gjyqësore, për shkak të uljes drastike të numrit të gjykatave në vend, veçanërisht në drejtim të të paturit vetëm një gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe problematikave që organizimi i ri gjyqësor krijonte për aksesin në drejtësi të njerëzve, vecanërisht atyre në nevojë.

Më shumë se tre vite nga miratimi i hartës së re gjyqësore, kjo tryezë synon zhvillimin e një debati me aktorë të rëndësishëm të fushës, për të reflektuar së bashku mbi mënyrën se si ri-organizimi gjyqësor po funksionon në praktikë, në kushte reale, duke patur në konsideratë vakancat e krijuara nga procesi i vetingut, rritjen e ngarkesës së punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit ndihmës, kapacitetet e kufizuara institucionale dhe si ndikojnë të gjitha këto tek distanca nga gjykatat vonesat me të cilët përballen përdoruesit e sistemit të drejtësisë.

Për qytetarët, drejtësia është një koncept praktik dhe i matshëm. Ajo nuk matet nga pesha që kanë fjalime të ndryshme mbi rëndësinë e reformave, por nga koha që ju duhet të presin për të marrë një vendim, kostot që paguajnë, distanca që duhet të përshkojnë për të aksesuar një gjykatë. Kur këto elemente bëhen të vështira, perceptimi i krijuar nuk është ai i reformës, por i largimit nga drejtësia dhe besimi tek ajo.

Sfidat aktuale pasqyrojnë një tranzicion të gjatë mbi sistemim, ku kanë ndodhur njëkohësisht disa ndryshime strukturore. Sistemi i drejtësisë sot po mban peshën e reformës duke vijuar të funksionojë — dhe kjo kërkon vëmendje institucionale të koordinuar midis të gjithë aktorëve dhe jo atribuim individual përgjegjësish.

Besimi publik tek drejtësia është i brishtë dhe praktik. Qytetarët përjetojnë pritjen dhe revoltohen me vonesat. Nëse procedurat zgjaten tej mase e drejtësia vonon me vite, edhe një reformë me qëllim të mirë sikurse është reforma në drejtësi rrezikon të preket rishtazi nga mungesa e besimit publik.

Mbrojtja e reformës është një mision i vështirë për kushtet e vështira të punës, dosjet e larta dhe presionin me të cilën punojnë organet e drejtësisë.

Çdo institucion i pranishëm në këtë tryeze mund të ofrojë zgjidhje ndaj shpresojmë që gjetjet e prezantuara të shërbejnë si pikënisje për dialog dhe zgjidhje të përbashkëta.

Roli i shoqërisë civile në këtë proces nuk është të qëndrojë jashtë institucioneve, por të veprojë si urë mes përvojës së qytetarëve dhe politikë bërjes institucionale. Monitorimi ka vlerë vetëm nëse kthehet në mësim dhe përmirësim.

Raporti mund të shërbejë si një kontribut i bazuar në evidencë për çdo rishikim të mundshëm të hartës gjyqësore, në përputhje me kriteret e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor. Duke analizuar aksesin në drejtësi, vonesat procedurale, ngarkesën e çështjeve ai ndihmon institucionet të marrin vendime të informuara. Edhe pa ndryshuar menjëherë hartën, gjetjet mund të përdoren për masa të tjera institucionale si rishpërndarja e burimeve ose përmirësimi i shërbimeve. Në këtë mënyrë raporti kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe garantimin efektiv të të drejtës për akses në gjykatë. Prandaj presim një diskutim të hapur, konstruktiv dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Të dhënat që KShH disponon në kuadër të përfaqësimit falas të grupeve në nevojë si pjesë e programit të Klinikës tonë Ligjore tregojnë se vonesat gjyqësore kanë një ndikim jo proporcional, veçanërisht komunitetet rom/egjiptian, njerëzit që janë në vështirës për shkak të gjendjes së tyre sociale dhe ekonomike si dhe komuniteteve të tjera të margjinalizuara përfshi LGBTI. Çështjet e tyre zgjasin nga 1 deri në 7 vite, ndërsa vetëm në apel pritja për shqyrtim mund të arrijë deri në 5–7 vite, duke e bërë mbrojtjen ligjore praktikisht joefektive. Këto vonesa nuk janë thjesht problem administrativ ato përkthehen në vazhdim të diskriminimit, mungesë shërbimesh sociale dhe pasiguri psikologjike për individët e prekur.

Për këtë arsye, çdo rishikim i hartës gjyqësore duhet të vlerësohet jo vetëm mbi eficiencën e gjykatave, por mbi ndikimin real që ka tek aksesi në drejtësi për qytetarët më vulnerabël.

Ju faleminderit!

Përmbledhje Ekzekutive

Reforma e hartës gjyqësore e zbatuar që prej vitit 2023, uli ndjeshëm numrin e gjykatave shqiptare nga 38 në 20 gjykata, duke përfaqësuar një nga përpjekjet më sfiduese të ristrukturimit gjyqësor.

KShH ndërmori këtë studim monitorimi që analizon performancën e pesë gjykatave të përzgjedhura për të vlerësuar ndikimin e rishpërndarjes territoriale të gjykatave sipas hartës së re, mbi efikasitetin gjyqësor dhe aksesin e qytetarëve në drejtësi. Harta e re gjyqësore synoi të garantojë një shpërndarje proporcionale dhe të balancuar të burimeve njerëzore dhe financiare në të gjitha gjykatat në raport me ngarkesën e tyre. Para miratimit së saj, sistemi gjyqësor i Shqipërisë ishte me vetëm 8.9 gjyqtarë për 100,000 banorë (28.4% nën mesataren rajonale) dhe kishte buxhetin më të ulët gjyqësor për banor në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ri-organizimi u kushtëzua nga faktorë si rritja e vakancave për shkak të procesit të *vetinggut*, që ndikoi ndjeshëm në uljen e kapacitetit të stafit gjyqësor, duke e reduktuar atë nga 88% që ishte në vitin 2014 në nivelin më të ulët 55% që është arritur ndonjëherë në vitin 2021. Aktualisht kur kanë kaluar afro 3 vite që prej vitit 2023 kur filloi zbatimi i hartës së re, KShH vlerëson se janë krijuar premisat bazë për një vlerësim të parë për matjen e efekteve të ndikimit të hartës së re gjyqësore. Për këtë qëllim janë përzgjedhur pesë gjykata të cilat u ndikuan drejtpërdrejt nga shkrirja e gjykatave të mëparshme dhe krijimi i gjykatave të bashkuara, si: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë që u bashkua me gjykatën Krujë; Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier që u bashkua me gjykatën Lushnjë; gjykata e apelit e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë që u bashkua me gjykatat e apelit Korçë, Vlorë, Durrës, Shkodër dhe Gjirokastër; Gjykata Administrative e Tiranës që bashkoi gjykatat e mëparshme Korçë, Shkodër dhe Durrës; si dhe Gjykata Administrative Lushnjë që bashkoi gjykatat administrative Gjirokastër dhe Vlorë. Sipas gjetjeve të këtij studimi, përmes monitorimit të pesë gjykatave të përzgjedhura, rezulton se:

i. Harta e re gjyqësore ka patur pjesërisht efekte pozitive në Gjykatën Administrative Tiranë, në të tre objektivat e përcaktuar në nenin 14 të ligjit 98/2016 , duke arritur 22.8% reduktim në kohën për gjykimin e rasteve (269.5 në 208 ditë), 63.3% rritje të produktiviteti (492.1 në 803.35 raste për gjyqtar), si dhe ka ruajtur normat e likujdimit (96.8% në 97.05%). Në këtë gjykatë ka pasur një reduktim të numrit të gjyqtarëve duke krahasuar të dyja periudhat me 54.2%, çfarë është reflektuar dhe në ndryshimin me +39.2 të raportit staf administrativ për gjyqtar në vite. Gjithsesi ngarkesa e gjyqtarëve në vit kërkon shtimin e stafit gjyqësor për të balancuar një shpërndarje sipas normave efecientë të ngarkesës së punës.

ii. Harta e re gjyqësore ka rezultate mikse referuar tre objektivave sipas nenit 14 të ligjit 98/2016 për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë, në drejtim të uljes së kërkesës gjyqësore, e cila mund të ketë ardhur për shkak të rritjes së distancave gjeografike për qytetarët e Krujës, por edhe për shkak të krizës që ka shënjuar gjykimin e ankimeve në gjykatën e Apelit, për shkak të kapacitetit të reduktuar gjyqësor. Ndërkohë, kjo gjykatë ka arritur të menaxhojë me rezultate te pjesshme kapacitetet e saj gjyqësore duke përmirësuar produktivitetin me 8.9% (582.6 në 633.95 rastet e zgjidhura për gjyqtar) edhe pse me rritje të kohës së gjykimit të rasteve civile me 125.9 % (nga 119.3 në 269.5 ditë), dhe 10.1% për rastet penale me (nga 69.15 në 76 ditë). Edhe për këtë gjykatë vlerësohet se shtimi i kapaciteteve në drejtim të administrimit të gjykimit përmes mjeteve dixhitale, finalizimi i projektit të platformës online për njoftimin e dokumenteve ndaj avokatëve të palëve, si dhe shtimi i stafit gjyqësor sidomos për seksionin e

çështjeve civile, do të zgjidhte disa vështirësi që hasen për shkak të ngarkesës së lartë të gjyqtarëve që arrin deri në 928 çështje për gjyqtar, në vit.

iii. Harta e re gjyqësore ka rezultate mikse referuar tre objektivave te nenit 14 të ligjit 98/2014 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e cila ka një kapacitet jo të mjaftueshëm gjyqësor për të përballuar ngarkesën e integruar pas bashkimit të dy gjykatave. Ndonëse numri i gjyqtarëve krahasuar me periudhën para reformës së hartës është rritur me 44%, rezulton se për këtë gjykatë ka një ulje të raportit staf administrativ për gjyqtar në masën 4.7% krahasuar me periudhën 2020-2022. Faktorë të tillë si shtimi i ngarkesës së gjyqtarëve si në sferën civile (mbi 900 raste për gjyqtar), ashtu dhe në sferën penale (mbi 840 raste për gjyqtar), shtimi i dosjeve arkivore (deri në 8000 dosje në vit), mungesa e ambienteve të duhura në godinën e gjykatës, me vetëm 5 salla gjykimi, kur një gjyqtar gjykon rreth 20-22 çështje në ditë, kërkojnë marrjen e masave urgjente për zgjidhjen e një godine të përshtatshme që lejon gjyqtarët aktualë të ushtrojnë në kushte normale funksionin e tyre, por edhe mundëson shtimin e stafit gjyqësor në të ardhmen si kusht për balancimin e ngarkesës së lartë të gjyqtarëve. Treguesit e uljes së efiçiencës në këtë gjykatë pasqyrohen në rritjen e kohës së disponimit të rasteve civile me 181.8% (98.15 në 276.5 ditë), dhe 27.8 % për rastet penale (nga 49.15 në 35.5 ditë), ulje e produktivitetit -4.9% (nga 595.4 në 566 raste të zgjidhura për gjyqtar), rënie në normat e likujdimit (10.4% për rastet civile dhe -5% për rastet penale). Këto tregues pasqyrojnë një gjykatë që po përballet me një krizë në kapacitetet e saj të pamjaftueshme gjyqësore.

iv. Harta e re gjyqësore ka pasur rezultate kritike për Gjykatën e JP të Apelit Tiranë, për të tre objektivat e përcaktuar në nenin 14 të ligjit 98/2014. Kjo gjykatë ka një dyfishim në kohën e disponimit të rasteve civile me 89.3% (nga 1,472.3 në 2787 ditë), dhe 130.4% (nga 370.7 në 854 ditë) për rastet penale, që çon në cenimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, si një nga standartet përbërëse të procesit të rregullit gjyqësor, i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së dhe 42 të Kushtetutës. Rritja shqetësuese prej 699.7% e *stokut gjyqësor* është pasojë direkte e bashkimt të 6 gjykatave të apelit në një të vetme, çka përfaqëson dhe reformën më radikale të hartës. Para hartës së re gjyqësore mesatarja e çështjeve ishte 4569 raste ndërsa në vitin 2023-2024 është 36,535 raste për gjykatën e vetme të apelit Tiranë), e cila përveç të tjerash funksionon me vetëm 36% kapacitet të stafit gjyqësor për shkak të efekteve të procesit të vetingut. Shtimi i stafit gjyqësor pengohet jo vetëm për shkak të barrierave në kriteret e emërimit për gjyqtarët e gjykatës së apelit, (që kërkojnë 7 vite eksperiencë pune për kandidatët) por edhe pasi godina aktuale nuk lejon më staf të ri, për shkak të ambienteve të pamjaftueshme. Vlerësohet si emergjente për zgjidhjen e vështirësive të evidentuara, marrja e masave si: shtimi i stafit gjyqësor, zgjidhja e godinës së re dhe shtimi i mjeteve dixhitale të aplikuara në mënyrë të kujdesshme pa cenuar aksesin në drejtësi të grupeve në nevojë, për zbutjen e barrierave të gjykimit në zonat e largëta.

v. Harta e re gjyqësore ka rezultate mikse në Gjykatën Administrative Lushnjë, e cila për shkak të shtimit të numrit të gjyqtarëve, konsolidimit të praktikës gjyqësore për gjykatat administrative, parashikimeve ligjore në juridiksionin e gjykimit administrativ (procedurat nuk pengohen për shkak të mos prezencës së palëve), referon se efektet fillestare ne treguesit e efiçencës për këtë gjykatë (një rritje në kohën e disponimit të rasteve 77, rënie produktiviteti 28.2%, si dhe rritje të stokut në 183 %) janë kalimtare, dhe të pranueshme për një gjykatë të re e cila bashkon dy gjykata të tjera ekzistuese.

Nga këto gjetje evidentohet se zbatimi i hartës së re ka sjellë rezultate pjesërisht të mira për Gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë.

Gjykata e Apelit të JP Tiranë ka një performancë në rënie për shkak të funksionimit me vetëm 36% të kapacitetit të stafit gjyqësor, me vetëm 28 gjyqtarë (mesatarisht)[1] nga 78 të parashikuar në total. Po ashtu treguesit e performancës për gjykatën e Shkallës së Parë të JP Fier dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, janë mikse me elementë kritikë veçanërisht për Gjykatën e JP Fier. Të dyja këto gjykata evidentojnë kërkesën për të krijuar dhe vënë në zbatim mekanzimat e duhur për menaxhimin e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, si dhe të *stokut gjyqësor* sipas kërkesave të nenit 94 të Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Konkluzionet kryesore të këtij studim monitorimi kanë evidentuar një sërë çështjesh si:

- rritje në kohën e gjykimit, sidomos për rastet civile (gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tirane dhe Fier, Gjykata e Apelit Tirane dhe administrative e shkallës së parë Lushnjë),
- shtimi i numrit të *stokut gjyqësor* (Apeli Tiranë, gjykata administrative Lushnjë),
- rënie e produktivitetit (gjykata e shkallës së parë të JP Fier, administrative Lushnjë)
- rënie e normës së likujdimit (NL) për rastet civile dhe penale (kryeson apeli Tiranë, ndjekur nga gjykata e shkallës së parë të JP Tiranë),
- rënie të NL vetëm për rastet civile (gjykata e shkallës së parë të JP Fier).

Nga këto çështje tepër shqetësues është ngadalësimi nga 77% në 180% i kohës së gjykimit sidomos për rastet civile, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku tejkalohen afatet e gjykimit për rastet civile që tani marrin mbi 6 vjet për t'u zgjidhur në krahasim me katër vite para miratimit të hartës. Po ashtu kjo gjykatë tejkalon afatet e gjykimit për çështjet penale mbi 489 ditë. Ky fakt përbën një risk serioz për cënimin e standarteve të procesit të rregullt sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi tejkalohen afatet ligjore 730 ditë për gjykimin e çështjeve civile dhe 365 ditë për rastet penale, sipas nenit 399 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa procesi gjyqësor i *vetnggut,* i projektuar dhe vënë në zbatim që prej vitit 2018 për të rritur integritetin gjyqësor, solli rënie të kapacitetit gjyqësor, duke krijuar efekte të padëshiruara me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve gjyqësore në shumicën e gjykatave dhe rrjedhimisht në interesat e qytetarëve përdorues të gjykatave për të marrë drejtësi brenda një kohe të arsyeshme. Si pasojë e këtyre problematikave, kjo eksperiencë e parë për rishikimin e hartës duhet të shërbejë si mësim për të ardhmen, ku kërkesa për aksesin në drejtësi të qytetarëve nuk duhet të vihet në pikëpyetje dhe sakrifikohet.

Një problematikë tjetër e evidentuar në këtë studim është se ka pasur ulje të kërkesës gjyqësore në tre prej pesë gjykatave (gjykata e apelit të JP Tiranë, e shkallës së parë të JP Tiranë, administrative Lushnjë), Ky fakt provon se përdoruesit e ish gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë që me hartën e re drejtohen në Gjykatën e rrethit Tiranë, si dhe përdoruesit e ish gjykatave administrative të shkallës së parë Gjirokastër dhe Vlorë të cilët me hartën e re duhet të drejtohen në gjykatën administrative të Lushnjës, tani përballen me distanca më të largëta të udhëtimit, kosto më të larta dhe pengesa të shtuara procedurale gjyqësore. Krijimi i zyrave administrative të informacionit përfaqëson një zgjidhje jo të plotë, që nuk mund të zëvendësojë aksesin e drejtpërdrejtë të gjykatës, sidomos për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm që trajtojnë çështje me procedura me komplekse. Ndikimi në mënyrë disproporcionale ndaj përdoruesve të këtyre gjykatave që prek kategoritë e personave më vulnerabël krijon pengesa për aksesin në

[1] E llogaritur su mesatare gjate periudhes viteve 2023-2024.

drejtësi, dhe cenon parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit sipas nenit 14 të KEDNJ, nenit 1 Protokolli 12 i KEDNj-së dhe nenit 18 të Kushtetutës.

Në vija të përgjithshme, mund të konkludohet se rezultatet pjesërisht pozitive sipas këtij studimi tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, janë pjesërisht tregues se zbatimi efektiv i hartës është i mundur kur planifikohet siç duhet. Rezultatet mikse dhe kritike në 4 gjykatat e tjera, që kanë rënie në performancën e tyre evidenton nevojën se qasja aktuale e hartës se re gjyqësore kërkon rivlerësim domethënës të të gjithë faktorëve të parashikuar në kërkesat ligjore për riorganizimin e shpërndarjes territoriale të gjykatave (nr.98/2016). Për këtë qëllim, KShH i bën thirrje institucioneve të drejtësisë (Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministrisë së Drejtësisë), për reflektimin e duhur ndaj eksperiencës së parë për rishikimin e hartës gjyqësore, për të korrigjuar efektet "e paparashikuara", në mënyrë që rishikimi pasues i hartës që sipas ligjit parashikohet pas 5 viteve në vitin 2028 të ofrojë garancitë e duhura të aksesit në drejtësi për qytetarët, në mënyrë të balancuar me kërkesën për efiçiencë të gjykatave.

Vlen të theksohet se buxheti gjyqësor për banorë edhe pse pati rritje në vitin 2025 në 17.5-euro për banorë krahasuar me vitin 2018 kur ishte vetëm 6-euro për banorë, mbetet ndjeshëm më i ulët se mesatarja evropiane prej 80-euro për banorë.

2. Metodologjia

Krijimi i KLGJ-së në vitin 2018 me kompetenca të plota për administrimin e pavarur buxhetor të gjykatave, rivlerësimin e shpërndarjes territoriale të gjykatave në mënyrë periodike çdo 5 vjet (neni 13 i Ligjit Nr. 98/2016),[2] dhe propozimin e rishikimit të hartës gjyqësore së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, krijoi kapacitetin institucional të nevojshëm për vlerësimin e shpërndarjes territoriale të gjykatave. Kjo qasje e re institucionale, mundëson një koordinim gjithëpërfshirës ndër-institucional për zbatimin efektiv të metodologjisë për rishikim periodik të performancës së gjykatave sipas kërkesave të Nenit 14 të Ligjit Nr. 98/2016[3], që synon përmbushjen e objektivave specifike[4] si, aksesi i qytetarëve në gjykata në mënyrë të balancuar: reduktimi i kostos dhe efikasiteti i burimeve: optimizimi i burimeve publike: përmirësimi i cilësisë së shërbimit.

Gjithashtu Neni 15/3 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon pikërisht kriteret mbi bazën e të cilave ndërtohet metodologjia e re e rishikimit të hartës gjyqësore, si përshtatja e riorganizimit territorial me ndarjet administrative të Shqipërisë; zhvillimi demografik; integrimi i zhvillimit ekonomik; vlerësimi i transportit dhe infrastrukturës; ndikimi i karakteristikave gjeografike; analiza e ngarkesës së gjyqtarëve dhe efikasitetit; optimizimi i burimeve njerëzore; koordinimi me institucionet penitenciare.

Në vështrim të objektivave dhe kritereve ligjore sa më sipër, për realizimin e këtij studimi janë përzgjedhur 5 gjykata në juridiksionet që janë ndikuar drejtpërdrejtë nga harta e re, përmes bashkimit me gjykatat e mëparshme, duke siguruar një përfaqësim të drejtë të gjykatave sipas natyrës së juridiksioneve të tyre, si p.sh: Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm (ka

[2] Ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021
[3] Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (6 tetor 2016)
[4] Objektivat: (1) garantimi i aksesit në drejtësi sa i përket afërsisë së qytetarëve me gjykatat; (2) reduktimi i kostove me qëllim përdorimin efiçent të burimeve publike; (3) rritjen e cilësisë dhe performancën e duhur të shërbimeve të ofruara

mbyllur 5 gjykata të mëparshme); Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (ku janë suprimuar apo mbyllur 9 gjykata të mëparshme); Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë (ka mbyllur 5 gjykata të mëparshme). Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë u zgjodh pasi përfaqëson ndikimin më të ndjeshëm tek qytetarët të hartës së re gjyqësore, si rezultat i bashkimit të 6 gjykatave të mëparshme të apelit (Tiranë, Vlorë, Shkodër, Korçë, Gjirokastra dhe Durrës). Kjo përzgjedhje mundëson vlerësimin e ndikimit që ka pasur shkrirja e gjykatave të apelit, tashmë në performancën e të vetmes gjykatë apeli të JP Tiranë, në drejtim të aksesit të qytetarëve, në procedurat gjyqësore deri në zgjidhjen përfundimtare të rasteve, dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore. Përveç gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, zgjedhja e dy gjykatave të vetme administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Lushnjë, mundëson një analizë krahasimore të efektit që ka pasur harta e re, nga njëra gjykatë tek tjetra. Për të identifikuar gjykatat ku harta e re mund të ketë ndikuar në kërkesën gjyqësore të qytetarëve janë përzgjedhur Gjykata e Shkallës së Parë të JP Tiranë dhe Fier. mbi bazën e treguesve specifik të performancës sipas raportit vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë vitit 2023, si disa nga gjykatat që kanë një fluks më të ulët të rasteve të reja krahasuar me një vit më parë. Gjykata e Shkallës së Parë të JP Tiranë pas bashkimit me juridiksionin e Krujës ka pasur ngarkesë të reduktuar të punës për gjyqtar, nga 1361 raste për gjyqtar në vitin 2022 në 1176 raste për gjyqtar në vitin 2023. Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë të JP Fieri pas bashkimit me juridiksionin e Lushnjës ka pasur ngarkesë pak më të reduktuar të punës së gjyqtarit nga 905 raste për gjyqtar në vitin 2022 në 851.5 raste për gjyqtar në vitin 2023. Për qëllimet e këtij studimi nuk janë marrë në konsideratë p.sh gjykatat që kanë pasur rritje të kërkesës gjyqësore nga përdoruesit e gjykatave, si gjykata e Durrësit që ka pasur rritje nga 1,011.7 në 1,412 raste për gjyqtar. Po ashtu për hartimin e këtij raporti analizohen dy periudha që mundësojnë krahasimin para dhe pas miratimit të hartës së re gjyqësore, duke identifikuar tendenca të ndikimeve që faktorë të caktuar kanë pasur në performancën e gjykatave pas zbatimit të hartës.

- Periudha e parë në vitet 2020-2022 përkon me vlerësimin e kritereve dhe treguesve për matjen e performancës nën strukturën ekzistuese të sistemit të gjykatave, si dhe ndikimin e saj gjatë procesit të *veting-ut*. Periudha trevjeçare mundëson identifikimin e tendencave para-ekzistuese dhe variacioneve të performancës gjyqësore që mund të kenë çuar në propozimin e hartës së re. Gjithashtu ajo shërben për të krahasuar treguesit e periudhës së dytë, në kuptim të efekteve që ka sjellë harta në raport me ngarkesën dhe efiçiencën e tyre si dhe kohëzgjatjes së gjykimeve.
- Periudha e dytë në vitin 2023-2024 përkon me fazën e zbatimit që identifikon ndikimet e menjëhershme të zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke evidentuar sfida që mund të jenë ndeshur gjatë periudhës tranzitore dhe tendencat fillestare të përshtatjes së gjykatave me hartën e re. Duhet pranuar se kjo periudhë për shkak të kushtëzimit që vjen prej aksesit të limituar të të dhënave statistikore, lejon evidentimin e trendeve fillestare të ndikimit të hartës por qartësia e këtij trendi mund të jetë më domethënës nëse shtrihet dhe në dy vitet pasuese 2025 dhe 2026.

Kuadri kohor 2020-2022 dhe 2023-2024 kërkon qasje të ndryshme për mbledhjen e të dhënave gjyqësore për secilën periudhë. Për periudhën para miratimit të hartës së re gjyqësore, mbledhja e të dhënave kërkon aksesimin e statistikave gjyqësore mbi aktivitetin e 16 gjykatave, duke përfshirë gjykatat që janë mbyllur me hartën e re. Ndërsa mbledhja e të dhënave gjyqësore pas zbatimit të hartës së re kërkon aksesimin e statistikave gjyqësore për vitin 2023-2024 vetëm për 5 gjykatat e përzgjedhura, që mundëson një analizë të ndikimit të hartës në gjykatën e bashkuar. Kjo qasje krahasimore e të dyja periudhave siguron një vlerësim të plotë duke përfshirë performancën e gjykatave të mëparshme që u mbyllën pas bashkimit në pesë gjykatat e përzgjedhura për këtë studim.

Në tabelën më poshtë jepen treguesit që janë marrë në konsideratë për kryerjen e kësaj analize.

Treguesit e ngarkesës	Treguesit e produktivitetit dhe eficencës	Vlerësimi i përdorimit të burimeve të gjykatës	Shpërndarja e burimeve	Vlerësimi i teknologjisë së avancuar
Numri i çështjeve të trajtuara në fillim të vitit	Koeficienti i efikasitetit = kosto për numër çështjesh të zgjidhura	Kostoja e përgjithshme gjyqësore	Disponueshmëria e informacionit online (udhëzime procedurale, statistika, procedura ankimimi)	Disponueshmëria dhe shfrytëzimi i dosjeve elektronike
Numri i çështjeve të zgjidhura për gjyqtar	Numri i stafit administrativ për numër gjyqtarësh	Efikasiteti i realizimit dhe ndarjes së buxhetit	Publikimi vendimeve online	Funksionaliteti i sistemit të menaxhimit të rasteve
Numri i çështjeve të regjistruara për gjyqtar	Norma e likujdimit = çështje të zgjidhura/çështje të pranuara (të matura veçmas për çështjet civile, penale dhe administrative)		Mundësitë e regjistrimit elektronik të çështjeve	Vendosja e sistemeve dhe mjeteve të IT-së
Numri i çështjeve të trajtuara në fund të vitit	Norma e disponimit të çështjeve në ditë e matur si raport i numrit të çështjeve të papërfunduara me numrin e çështjeve të gjykuara x 365 ditë		Qasja dixhitale në dispozicion të drejtësisë	Funksionaliteti i faqes së internetit dhe aksesueshmëria e qytetarëve
Çështje të mbetura pezull në fund të vitit (backlog)				

Analiza tërësore e studimit është realizuar përmes raporteve vjetore të KLGJ-së (2018-2025), kërkesave për informacion dhe përgjigjeve shkresore të marra si nga institucioni i KLGJ-së, dhe nga pesë gjykatat e përzgjedhura, po ashtu informacioni i marrë nga institucioni i Avokatit

të Popullit.[5] Për të pasur një vlerësim sa më cilësor të të dhënave statistikore gjyqësore të përdorura për këtë raport, janë përdorur në mënyrë plotësuese statistikat e marra nga vjetarët statistikorë të publikuara nga Ministria e Drejtësisë.[6] Një rëndësi të veçantë për këtë qëllim kanë pasur dhe takimet e zhvilluara nga ekspertja që ka realizuar studimin me kryetarët (apo zëvendëskryetarët) dhe kancelarët e gjykatave ne fazën përmbyllëse të raportit.

3. Vështrim historik i reformës për rishikimin e hartës gjyqësore

Sipas dokumentit analitik që shërbeu si pikënisje për reformimin e sistemit të drejtësisë,[7] sistemi gjyqësor shqiptar gjatë periudhës së viteve 2014-2016 ishte në një pikë kritike që kërkonte një riorganizim gjithëpërfshirës të gjykatave. Sipas kësaj analize, sistemi përbëhej nga 38 gjykata që j'u shërbenin rreth 2.9 milion banorëve, me një numër prej 1.3 gjykatash për 100,000 banorë, nën mesataren evropiane prej 1.8. Sistemi përbehej nga 22 gjykata të juridiksionit të përgjithshëm me një numër prej 0.8 gjykatash të shkallës së parë për 100,000 banorë, më të ulët se standardi evropian prej 1.5. Përveç kësaj, sistemi kishte kufizime në burimet njerëzore me 13.1 gjyqtarë për 100,000 banorë në krahasim me mesataren evropiane prej 20.6. Numri i gjyqtarëve të miratuar me dekret të Presidentit që varionte rreth 402-408 mbështetej nga staf administrativ prej 828-902 nëpunësish, duke krijuar një raport staf për gjyqtar prej 2.34, poshtë standardit evropian 3.9. Pavarësisht kësaj, në atë periudhë, normat e likujdimit të rasteve civile ishin relativisht të qëndrueshme dhe afërsisht të njëjta me mesataren evropiane prej 101% (2014), 109% (2015), dhe 95% (2016).

	2014	2015	2016	Mesatare 2014-2016	Trendi	Rezultati
Numri i gjyqtarëve	402, sipas Dekretit (D) 398, efektivisht në organikë (O)	402 D 361 O	408 D 351 O	370	↓	Rënie e moderuar e kapacitetit të stafit gjyqësor
Numri i gjyqtarëve/staf administrativ	2.08	2.45	2.5	2.34	↑	Përmirësim i moderuar
Norma e likujdimit (NL)	101%	109%	95%	1.01%	→	Normë e qëndrueshme
Koha e disponimit (KD)	109.3	135.25	146.7	130.4	↑	Normë në rritje
Numri i vakancave	4	41	57	34	↑	Rritje e vakancave

[5]Përgjigje e gjykatës sw shkallws sw parw tw JP Tiranë, me shkresë nr. 7441/1, datë 3.02.2025; Shkresë e Gjykatës apelit juridiksioni i përgjithshëm, nr.22156/1, datë 6.01.2025; Shkresë e gjykatës administrative shkalla e parë Lushnje nr.877/1, datë 26.11.2024; Shkresë e gjykatës rrethit gjyqësor Fier, nr.10559/1, datë 2.12.2024; informacion i Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresë zyrtare nr.370/1, datë 5.02.2025; informacion zyrtar nga Avokati i Popullit

[6]Shih tabelën mbi metodologjinë e përdorur në aneksin bashkëlidhur

[7]Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Dokument analitik i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën e Drejtësisë, Qershor, 2015.

Numri i gjyqtarëve për 100.000 banorë	14.2	12.8	12.5	13.1	↓	Rënie
Raste të zgjidhura /gjyqtar	260.8	298.3	254.9	271.3	→	Normë e qëndrueshme
Ngarkesa/gjyqtar	343.3	420.3	426.4	396.6	↑	Rritje
Stoku gjyqësor	40932	56224	60200	52452	↑	Rritje
NL (gjykatat e rretheve/civile)	94%	96%	97%	95.6%	↑	Rritje
NL (gjykatat e rretheve/penale)	89%	93%	95%	92.3%	→	Rritje e qëndrueshme

Sistemi në tërësi karakterizohej nga një shpërndarje e pabarabartë e burimeve njerëzore ku kanë dominuar 14 gjykata të vogla me 4-6 gjyqtarë, me një raport 3:1 staf administrativ për gjyqtar, më i lartë se raporti 1.3:1 për gjykatat e mesme të cilat kishin nga 10-14 gjyqtarë. Kjo situatë krijonte një barrë për gjykatat më të mëdha për shkak të ngarkesës për gjyqtar e cila ishte e pa balancuar, si p.sh ajo e gjykatës së shkallës së parë të JP Tiranë me 76 gjyqtarë dhe 124 staf administrativ, që trajtonte rreth 50% të ngarkesës totale të gjykatave në rang vendi. Koha e disponimit të rasteve civile ka qenë vazhdimisht në rritje nga 109.3 ditë në 2014, në 135.25 ditë në vitin 2015, në 146.6 ditë në vitin 2016, duke kapërcyer mesataren evropiane 133 ditë. Sistemi ka pasur vazhdimisht mungesa në drejtim të përdorimit të teknologjisë në gjykata, e cila për Shqipërinë kishte një indeks prej 3.0 kryesisht e mjaftuar vetëm në pajisje bazike, shumë herë më e ulët se mesatarja evropiane prej 5.5. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat e performancës për gjykatat administrative dhe të apelit.

TREGUESIT	GJYKATAT	2014	2015	2016	MESATARE 3-VITE	TRENDI	PERFORMANCA
TREGUESIT E NGARKESËS PËR GJYQTARË							
Raste të regjistruara (Mesatare)	**Administrative**	3,340	2,945	3,262	3,182	→	Volum i qëndrueshëm
	Apel	494	1,767	941	1,067	↑	Luhatje e lartë
Raste të përfunduara (Mesatare)	**Administrative**	3,063	2,988	2,903	2,985	↓	Rezultat në rënie
	Apel	490	1,138	991	873	↑	Rezultat i variueshëm
Ngarkesa (Mesatare)	**Administrative**	3,615	3,390	3,686	3,564	→	Ngarkesë konstante
	Apel	691	2,195	1,579	1,488	↑	Ngarkesë në rritje
TREGUESIT E EFICENCËS DHE PERFORMANCËS							

TREGUESIT	GJYKATAT	2014	2015	2016	MESATARE 3-VITE	TRENDI	PERFORMANCA
Norma e Likujdimit -	**Administrative**	**0.913**	**0.998**	**0.843**	**0.918**	↓	Rënie
	Apel	**0.958**	**0.945**	**1.082**	**0.995**	↑	Optimale
Koha e disponimit (Ditë)	**Administrative**	**65.4**	**128.2**	**128.1**	**107**	↓	Situatë kritike
	Apel	**200.2**	**392.2**	**135.5**	**243**	→	Përmirësim
KAPACITETI I BURIMEVE NJERËZORE							
Numri i gjyqtarëve (Mesatare)	**Administrative**	5.4	5.5	5.5	5.5	→	Staf i qëndrueshëm
	Apel	8.0	13.7	11.7	11.1	↑	Kapacitet i zgjeruar
Stafi Admin (Mesatare)	**Administrative**	14.6	17.5	19.5	17.2	↑	Rritje e mbështetjes me staf
	Apel	13.3	25.6	21.0	20.0	↑	Zgjerim i stafit
Raste per gjyqtar	**Administrative**	565	563	570	566	→	Ngarkesë e lartë
	Apel	61	83	85	76	↑	Ngarkesë e moderuar
TREGUESIT E CILËSISË DHE KOHËZGJATJES							
Respektimi i afateve kohore (%)	**Administrative**	**74.0%**	**77.7%**	**70.5%**	**74.1%**	↓	Rënie e cilësisë
	Apel	**79.5%**	**75.4%**	**69.7%**	**74.9%**	↓	Rënie
Raste që tejkalojnë 6 muaj (%)	**Administrative**	26.0%	22.3%	29.5%	25.9%	↓	Vonesa të rritura
	Apel	20.5%	24.6%	30.3%	25.1%	↓	Vonesa
TREGUESIT E KOSTOS							
Kosto për rast (leke)	**Administrative**	6,949	6,759	6,720	6,809	↑	Kosto efiçente
	Apel	*Nuk ka të dhëna të plota*				-	-

Për gjykatat administrative situata paraqitej më problematike me normat e likujdimit që luhateshin nga 91% (2014) në 99% (2015), pastaj në 84% (2016), nën mesataren evropiane 107%. Ndërsa koha e disponimit për këto raste ka variuar nga 65.4-128.1 ditë, ku respektimi i afateve limit ka arritur në masën 74.1% të çështjeve, dhe tendenca për krijimin e tejzgjatjeve

mbi afatin 6 mujor ishte në masën 25.9% të çështjeve. Po ashtu, gjykatat administrative kanë shfaqur një shpërndarje jo uniforme të treguesve të efiçencës, ku gjykata e shkallës së parë Gjirokastër kishte një normë likujdimi 91-93% dhe normë disponimi 30-42 ditor, ndërsa gjykata e Shkodrës ka pasur norma më të ulëta të likujdimit nga 50-114 %[8] dhe kohë të disponimit të rasteve nga 224-353 ditë. Për të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë vërehet ngarkesë e lartë e rasteve në total që varion nga 18,000 deri në 20,000 çështje në vit, me një numër total prej 28-29 gjyqtarësh, duke çuar në një ngarkesë të lartë të gjyqtarëve që ka variuar nga 693.6 në 838.8 raste për gjyqtar. Në situatë më shqetësuese ka qenë dhe gjykata e apelit administrativ, me ngarkesë të lartë çështjesh që varionte nga 6508 deri në 11280 raste të regjistruara, e cila me vetëm 13-11 gjyqtarë ka pasur një ngarkesë të lartë për gjyqtar që varionte nga 1362.1 (2014) në 1609.7 raste në vitin 2016 (pra dyfishin e ngarkesës së gjykatave administrative të shkallës së parë).

Ndërsa në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (JP) koha e përpunimit të rasteve ka variuar nga 200 ditë (2014) në 392 ditë (2015), në 136 ditë në vitin 2016 duke ruajtur një normë shumë të mirë të likujdimit të rasteve përgjatë tre viteve. Pavarësisht kësaj, përqindja e rasteve për respektimin e kohës limit ka qenë 74.9% krahasimisht e njëjtë me gjykatat administrative, të cilat kanë pasur një ngarkesë shumë herë më të lartë. Në gjykatat e apelit të JP, pavarësisht faktit se ngarkesa ka qenë e lartë duke variuar nga 11,875 raste deri në 17,167 raste në vitin 2016, numri total i gjyqtarëve gjatë këtyre tre viteve ka variuar nga 70-74 gjyqtarë, ndryshe nga gjykatat administrative ku numri total i gjyqtarëve ishte 29 për shkallën e parë dhe 13 për shkallën e apelit. Kjo ka lehtësuar ngarkesën e gjykatave të apelit të JP, për gjyqtar, e cila mesatarisht përgjatë viteve ka qenë 494 raste për gjyqtar, shumë herë me e ulët krahasuar me gjykatat administrative. Në përfundim, në vështrim të sa më lart, mund të konkludohet se nën ndikimin e të gjithë faktorëve si: treguesit e ngarkesës, pabarazitë gjeografike, shpërndarja e pa balancuar e burimeve njerëzore, problemet e hasura në gjykatat e apelit të JP dhe ato administrative, kanë diktuar kërkesën për një riorganizim të sistemit gjyqësor që të garantonte një shpërndarje të balancuar të burimeve dhe fuqizimin e normave të efiçiencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore.

4. Vështrim mbi situatën në sistemin gjyqësor gjatë viteve 2018-2024

Procesi i *vetingut* solli rënie të numrit të gjyqtarëve nga 15.0 gjyqtarë për 100,000 banorë në vitin 2018, në vetëm 7.91 gjyqtarë për 100,000 banorë në vitin 2021. Kjo rënie progresive prej 47% rezulton ndjeshëm nën standardet evropiane. Kapaciteti i stafit gjyqësor në sistemin e gjykatave arriti në nivelin më të ulët prej 55% në vitin 2021, me vetëm 224 gjyqtarë efektivisht në detyrë, nga 408 pozicione të miratuara me dekret të Presidentit. Në këtë vit po ashtu norma e likujdimit në total për të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve ka qenë më e ulët se të gjitha vitet e tjera (66%), ndërsa koha e disponimit të çështjeve më e lartë po ashtu (201.1). Në rang kombëtar, niveli i performancës së të gjitha gjykatave në total, mesatarisht ngarkesa për gjyqtar ka qënë 896 raste për gjyqtar, dhe numri i rasteve në fondin *e stokut gjyqësor* ka qenë 109,073.4 raste. [9] Më kritike ka qenë situata në Gjykatën e Lartë, e cila ka funksionuar në vitin 2021 me 39% të kapacitetit të saj të stafit gjyqësor, me vetëm 7.33 gjyqtarë nga 19 pozicione të miratuara, situatë e cila u përmirësua në vitin 2024 me plotësimin e vakancave të saj deri në 17 gjyqtarë.[10] Ndërsa gjykatat e apelit arritën në 42% të kapacitetit të stafit gjyqësor me 32.9

[8] 0.508-1.143
[9] Shih tabelën 1 në aneks
[10] Raporti vjetor I KLGJ për vitin 2018-2024.

gjyqtarë në vitin 2021 dhe 28 gjyqtarë në vitin 2024, nga 78 pozicione të miratuara. Edhe pse pati 268 vendime për largimin e magjistratëve nga sistemi deri në vitin 2024 në kuadër të procesit të vettingut, gjykatat arritën të ruajnë një normë të mirë likujdimi të rasteve pavarësisht rritjes së numrit të backlog-ut. Po ashtu buxheti gjyqësor për banorë edhe pse pati rritje në vitin 2025 në 17.5-euro për banorë krahasuar me vitin 2018 kur ishte vetëm 6-euro për banorë, mbetet ndjeshëm më i ulët se mesatarja evropiane prej 80-euro për banorë.

5. Monitorimi i zbatimit të hartës gjyqësore (2022-2024)

Ri-organizimi i ri gjyqësor, i zbatuar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 495 datë 27.7.2022,[11] rishpërndau territorialisht gjykatat sipas treguesve të pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Përmbledhje e rishikimit të hartës gjyqësore

Gjykata	Para Reformës (2022)	Post-Reformës (2023)	Metoda e shtrirjes territoriale	Impakti gjeografik
Total	38	20	Shkrirje strategjike	-38% më pak vendndodhje gjeografike të gjykatave
Të rretheve gjyqësore	22	13	Bashkim i gjykatave të vogla me ato të mesme apo të mëdha	9 mbyllje gjykatash dhe krijimi i Zyrave administrative të informacionit
Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm	6	1	Shkrirje totale në një institucion të vetëm	Mbyllje e 5 gjykatave dhe centralizim në gjykatën e apelit Tiranë
Apeli administrative	1	1	-	-
Administrative	6	2 (Tirana, Lushnja)	Shtrirje mbi bazë ndarje rajonale	5 mbyllje gjykatash dhe krijimi i Zyrave administrative të informacionit
Anti- korrupsion (shkalle e parë dhe apel)	2	2	-	-

Nga analiza e performancës së pesë gjykatave të përzgjedhura për këtë raport studimor, janë evidentuar disa gjetje që reflektojnë se si kanë operuar ato para dhe pas miratimit të hartës së re gjyqësore.[12] Më konkretisht:

[11]VKM-së Nr.495, datë 21.7.2022, "Për riorganizimin e Rretheve Gjyqësore dhe kompetencave tokësore të Gjykatave".
[12]Për më shumë detaje shih tabelën 3 në aneks.

5.1 Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë

Kjo gjykatë u bashkua me ish Gjykatën e shkallës së Parë të JP Krujë dhe rezulton se ka pasur rezultate mikse nën ndikimin e hartës së re gjyqësore. Shkalla e likujdimit të çështjeve të kësaj gjykate është përmirësuar lehtë, nga 97.05% në periudhën para zbatimit të hartës 2020-2022 në 94.9% në periudhën gjatë zbatimit të saj 2023- 2024, duke treguar se gjykata po ruan ritmin me shtimin e rasteve të reja dhe po redukton lehtë dhe stokun gjyqësor të saj. Gjate periudhës 2023-2024 rastet e zgjidhura për gjyqtar u rritën nga 612 në vitin 2023 në 655.9 në vitin 2024, edhe pse ngarkesa e çështjeve për gjyqtar u rrit nga 852 në 1,005.9 çështje për gjyqtar. Kjo tregon se gjyqtarët janë përshtatur për të përfunduar volume më të mëdha të ngarkesës me raste, pa ndikim proporcional në kohën e disponimit të çështjeve, e cila mbeti relativisht e qëndrueshme, duke u përmirësuar lehtë për rastet civile nga 273 ditë në 2023 në 266 ditë në vitin 2024, ndërsa për rastet penale rezultoi me rritje të lehtë nga 69 në 2023 në 76 në 2024. Megjithatë, në treeguesit e përmirësuar ka ndikuar edhe numri i rasteve të reja në këtë gjykatë nga 53614.3 në periudhën 2020-2022 pësoi rënie në 32,706 raste te ardhura në përudhën 2023-2024. Ky tregues mbart elementë kritikë pasi bashkimi i gjykatave mund të ketë krijuar pengesa për qytetarët nga juridiksioni i ish-gjykatës Krujë, të cilët tani duhet të udhëtojnë drejt Tiranës për të marrë shërbimet gjyqësore nga ky juridiksion i shkallës së parë. Numri i çështjeve të mbetura pezull në fund të vitit u përmirësua lehtë duke mbetur gjithsesi në shifra të larta mbi 19,000 raste, ndërsa kostoja për rastet e zgjidhura u rrit ndjeshëm në 20,439 lekë.

Tabela 6: Performanca e Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Tiranë

Treguesit (e ponderuar)	**Para miratimit të hartës (2020-2022)**	**Pas miratimit të hartës 2023-2024**	**Ndryshimi (%)**	**Vlerësimi**
Norma e likujdimit	95,3%civile 98,8% penale = 97,05	94.9%[13]	-2.2 %	përmirësim
Koha e disponimit	119.3 (ditë) civile 69 penale	269.5[14](ditë) civile 76 penale	+125% (civile) +10.1 % (penale)	ka nevojë për stabilizim
Raste për gjyqtar	724,3	928.9[15]	+28.2 %	ruajtje e krahasueshme e produktivitetit
Raste të zgjidhura për gjyqtar	582	633.9[16]	+8.9 % kundrejt hendekut	përmirësim i lehtë
Stoku gjyqësor	25597	19,050	+25,5%	I kontrolluar
Raste të reja	53614.3	32706	-38,9%	Rënie kritike

[13]NL në vitin 2023 është 78%, ndrsa në vitin 2024 është 111.8%.
[14]273 ditë për rastet civile në 2023, 266 ditë në vitin 2024.
[15]852 raste/gjyqtar në 2023, 1005,9 në vitin 2024.
[16]612 raste të zgjidhura në vitin 2023, dhe 655.9 në vitin 2024.

5.2 Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Fier

Kjo gjykatë u bashkua me ish-Gjykatën e shkallës së parë të JP Lushnjë, paraqet rezultate mikse por me një ndikim më kompleks të hartës së re gjyqësore. Ndërsa performanca e kësaj gjykate arriti të ketë norma më të mira për zgjidhjen e rasteve (nga 78% në vitin 2023 në 101.2% në vitin 2024) që tregojnë rritje të produktivitetit gjyqësor, ndikimi i hartës së re ndaj kësaj gjykate me kalimin në gjykatën bashkuese ka qene më i vështirë sesa në rastin e gjykatës së shkallës së parë të JP Tiranë. Gjykata e Fierit pati një rritje të konsiderueshme të çështjeve të reja, nga një mesatare prej 5,202 në vitet 2020-2022 në 7,328 raste në vitin 2023, çfarë tregon se është arritur një integrim i ngarkesës së çështjeve me gjykatën e mëparshme të rrethit Lushnjë. Megjithatë, koha e përfundimit të gjykimit të rasteve u rrit nga një mesatare prej 91 ditësh para reformës në 129 ditë në vitin 2023, dhe numri i çështjeve të prapambetura pothuajse u trefishua nga 1,289 në 3,101 çështje. Kosto për çështje të zgjidhura u rrit nga një mesatare prej 14,661 lekësh në vitet 2020-2022 në 17,800 lekësh në vitin 2023. Kjo tregon se gjykata po likujdonte më shumë çështje, por me kosto dukshëm më të larta për çështje.

Tabela 7: Performanca e Gjykatës së shkallës së parë të JP Fier

Treguesit	**Para miratimit të hartës (2020-2022)**	**2023**	**2024**	**Pas miratimit të hartës 2022-2024**	**Ndryshimi (%)**	**Vlerësimi**
Norma e likujdimit (NL)	96,95 - 100	78 Civile 101 penale	101.2 civile 105.8% penale	89.6 103.4	-10,4% civile -5% penale	Rënie e lehtë
Koha e disponimit	98.15 (civile) 49.15 (penale)	273 civile 52 penale	280 civile 19 penale	276.5 civile 35.5 penale	+181.7% civile -27.8% Penale	Përkeqësim në rastet civile Përmirësim në rastet penale
Raste për gjyqtar	681.3	852	674.5	763.25	+ 12%	Rritje e lehtë e ngarkesës
Raste të zgjidhura për gjyqtar	595.4	612.4	521.1	566.55	-4.9%	Rënie e lehtë
Raste te mbetura pezull (Backlog)	876.6	1355	2,582	1968	+124%	Rritur ndjeshëm
Raste të reja	4318.4	7328	7401	7364.5	+70.5%	Rritje e kërkesës gjyqësore

5.3 Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përfaqëson modelin më ndjeshmëri më të lartë për qytetarët dhe publikun të reformës për rishikimin e hartës së re gjyqësore, pasi nën këtë gjykatë u shkrinë gjashtë gjykatat e mëparshme të apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pas bashkimit, Gjykata e Apelit të JP Tiranë integroi ngarkesat me raste të kombinuara me juridiksionet e përgjithshme të gjykatave të apelit të Tiranës, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Gjirokastrës dhe Durrësit. Të dhënat statistikore tregojnë se kjo gjykatë ka pasur rritje shqetësuese të rasteve të mbetura pezull nga një mesatare prej 4569 raste para miratimit të hartës në 31,362 në vitin 2023 dhe në 41,708 në vitin 2024. Vihet re një rritje e produktivitetit për gjyqtar nga mesatarja prej 315.15 rasteve të zgjidhura në vitet 2020-2022 në 341 në vitin 2023 dhe 371.7 në vitin 2024. Norma e likujdimit të çështjeve, edhe pse u përmirësua mbeti problematike në 42% për disponimin e rasteve civile në vitin 2023 dhe 64.2% në vitin 2024, që do të thotë se gjykata po përfundonte gjykimin e shumë më pak rasteve se sa po pranonte raste të reja. Ndërsa disponimi për rastet penale ka pësuar rritje nga 64% (2023) në 76% (2024). Ngarkesa e rasteve për gjyqtar arriti në 1,945.3 raste në vitin 2024, afërsisht më shumë e dyfishuar nga mesatarja 896.2 raste për gjyqtar në periudhën 2020-2022. Kjo përbën një barrë të lartë për gjyqësorin, me pasoja negative në cilësinë e vendimmarrjes gjyqësore. Kjo situatë kritike shpjegohet me mungesën e theksuar të stafit ku gjykata e apelit ka operuar në vitin 2024 me mesatarisht 28 gjyqtarë kundrejt numrit të miratuar prej 78 gjyqtarësh, që përfaqëson një normë vakance prej 69% të stafit gjyqësor. Sipas parashikimeve të strategjisë së KLGJ-së për reduktimin e stokut gjyqësor,[17] nëse produktiviteti i kësaj gjykate rritet me 50%, gjykata mund të arrijë të evadojë stokun e saj deri në vitin 2029, një afat kohor që ngre pikëpyetje serioze rreth qasjes në drejtësi për përdoruesit e gjykatës. Numri i rasteve të reja në periudhën 2023-2024 në këtë gjykatë është në masën 14,197, çka ka pësuar ulje në raport me rastet e reja prej 15,046.7 të paraqitura në 6 gjykatat e apelit para miratimit të hartës gjyqësore. Ky fakt tregon se kërkesa gjyqësore me ri-organizimin e vetëm gjykatë të apelit të JP mund të ketë shkurajuar qytetarët për t'iu drejtuar kësaj gjykate, krahasuar me periudhën para zbatimit të hartës në një masë prej -5.6% më pak.

Tabela: Analiza për Gjykatën e Apelit të JP Tiranë

Treguesit	**Para miratimit të hartës (2020-2022)**	**2023**	**2024**	**Mesatare pas 2023-2024**	**Ndryshimi %**
Numri total i gjyqtarëve sipas dekretit	78	78	78	78	0% (pandryshuar)
Gjyqtarë efektivë	70-75	32	24	28	-61.4% ↓
Stoku gjyqësor	27,414.4/6 4569	31,362	41,708	36,535	+699.7% ↑
Norma e likujdimit	449.2 civile + 501.2 penale/6	42% civile 64.2 penale	64.2% civile 76 penale	53.1%civile 75% penale	-29% civile↓ -10.2% penale

[17] Shih strategjia për reduktimin e backlogut e miratuar nga KLGJ (2024)

	74.8 civile 83.5 penale				
Koha e disponimit	8,834.2 civile +2,224.4 penale/6 1472.3 civile 370.7 penale	2,791 civile 885penale	2683civile 823 penale	2787 ditë civile 854 penale	+89.3% civile +130.3 penale
Raste për gjyqtarë	5,377.5/6 896.2	1,904	1,945.3	1,924.65	+114.8% ↑
Raste të zgjidhura për gjyqtarë	1,892.1/6 315.35	341	371.7	356.35	+13% ↑
Raste të reja	15,046.7/6 2507.7	14,507	13,888	14197	+466.1%
Projektimi i evadimit të Stokut nga KLGJ	-	2029	2029	**2029**	-

5.4 Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë bashkoi juridiksionet e katër gjykatave të mëparshme administrative të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë. Ky bashkim tregoi se ka arritur efekte pjesërisht pozitive, krahasuar me gjykatat e tjera të analizuara në këtë raport studimor, në raport me objektivat ligjorë të parashikuar për riorganizimin gjyqësor. Gjykata ka ruajtur një normë të mirë të likujdimit (91% në vitin 2023, duke u përmirësuar në 103.1% në 2024) ndërsa ka rritur ndjeshëm produktivitetin me numrin e rasteve të zgjidhura për gjyqtar, nga një mesatare prej 254 në vitin 2020-2022 në 670 në vitin 2023 dhe 936.7 në vitin 2024, një rritje gati katërfish. Ky përmirësim tregon se përmes performancës së kësaj gjykate, harta e re gjyqësore ka arritur të ketë efektin më optimal të saj në raport me gjykatat e tjera objekt monitorimi, pavarësisht rritjes së ngarkesës së saj me raste. Kjo gjykatë ka arritur të menaxhojë rastet e reja të regjistruara në mënyrë më efektive, pavarësisht rritjes së numrit të tyre nga një mesatare prej 6,795 para miratimit të hartës në 12,913 në vitin 2023. Megjithatë, koha e disponimit të rasteve u rrit ndjeshëm nga një mesatare prej 119 ditë në 217 ditë në vitin 2023, edhe pse u përmirësua lehtë në 199 ditë në vitin 2024. Rastet e stokut gjyqësor gjithashtu u rritën ndjeshëm, nga një mesatare prej 2,089 raste në 7,014 në vitin 2023, drejt një përmirësimi të lehtë në 6,646 në vitin 2024.

Tabela 9: Performanca e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

Treguesit	**Para miratimit (2020-2022)**	**2023**	**2024**	**Mesatarja 2023-2024**	**Ndryshimi %**	**Vlerësim**
Norma e likujdimit	387.2/4 96.8%	91%	103.1 %	97.05%	+0.25 %	Përmirësim
Koha e disponimit	1,078.5/4	217 ditë	199 ditë	208 ditë	- 22.8 %	Rënie e konsideruesh me

	269.5 ditë					
Raste për gjyqtar	3,116.2/4 779	1068	1,447.9	1,257.95	+61.4	Rënie krahasuar me vlerën e integruar/rritje krahasuar me mesataren/
Raste të zgjidhura/gjyqtar	1,968.5/4 492.1	670	936.7	803.35	+63.2%	Rritje krahasuar me mesataren/rënie krahasuar me vlerën e integruar në total
Raste të reja	12,054.6/4 3013.65	12,913	11,809	12,361	+310% + 2.54%	Rritje krahasuar me mesataren/rritje lehtë krahasuar me vlerën e integruar
Stok gjyqësor	5,157.6/4 1286.4	7,014	6,646	6,830	+430.0% krahasuar me mesataren	I katërfishuar

5.5 Gjykata Administrative e shkallës së parë Lushnje

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje bashkoi ish-gjykatat administrative të shkallës së parë Gjirokastër dhe Vlorë. Ky riorganizim ka sjellë rënie të numrit rasteve hyrëse, më të ulëta nga mesatarja prej 3,101 në vitet 2020-2022, në 2,522 raste në 2023. Kjo e dhënë sugjeron se ndikimi i hartës mund të ketë krijuar pengesa në qasje për qytetarët e gjykatave të mëparshme në gjykatën e bashkuar.

Norma e likujdimit të gjykatës ra nga një mesatare prej 91% në 87% në 2023, dhe koha e disponimit të rasteve ka pasur rritje drastike, gati në dyfishim, nga 152 në 292 ditë. Produktiviteti gjyqësor ka pasur ulje gjithashtu me rastet e zgjidhura për gjyqtar nga një mesatare prej 467 para miratimit të hartës, në 369 në vitin 2023.

Tabela 10: Performanca e Gjykatës Administrative të shkallës së parë Lushnje

Treguesit	**Para miratimit (2020-2022)[18]**	**2023**	**2024**	**Mesatarja 2023-2024**	**Ndryshimi %**	**Vlerësim**

[18]Total 2 gjykatat administrative Gjirokastër + Vlorë.

Norma e likujdimit	184.6/2 92.3%	87%	100.9%	**93.95%**	**+1.7%**	Përmirësim i lehtë
Koha e disponimit	304.6/2 152 ditë	292 ditë	247 ditë	**269.5 ditë**	**+77.3%**	Dyfishim
Raste të zgjidhura/gjyqtar	1,103.3/2 551.6	369	416	**392.5**	**-28.8%**	Rënie e konsiderueshme
Ngarkesa për gjyqtar	1,554.2/6 777.1	676	699.1	**672.6**	**-13.4%**	Rënie
Raste të reja	**3,110**.3/2 1,555.15	2,522	2,561	**2,541.5**	**+64.0%** **-18.2%**	Rritje krahasuar me mesataren dhe rënie krahasuar me vlerën e integruar
Stok Gjyqësor	1,242.3/2 621.15	1,774	1,750	**1,762**	**+183.7%**	Pothuajse trefishuar

6. Analiza e gjetjeve për të dyja periudhat: para miratimit të hartës (2020-2022) dhe pas (2023-2024)

Nga analiza e krahasimit të të dhënave të integruara për pesë gjykatat për të dyja periudhat para miratimit të hartës (2020-2022) dhe pas (2023-2024), rezulton se harta gjyqësore nuk ka dhënë rezultatet e synuara. Më konkretisht gjetjet mbi efektet e ndryshimeve respektive për secilën gjykatë sa i takon indikatorëve kryesorë: koha e disponimit (KD), norma e likujdimit (NL), rastet e zgjidhura për gjyqtar, kërkesa gjyqësore e përdoruesve të gjykatës dhe trendet e rasteve të prapambetura (stok) nga 2020-2022 deri 2023-2024 evidentohen në tabelën më poshtë[19]:

Treguesi	**Gjykata e Shkallës së Parë, JP Tiranë**	**Gjykata e Shkallës së Parë, JP Fier**	**Gjykata e Apelit JP, Tiranë**	**Gjykata Admin e Shkallës së parë, Tiranë**	**Gjykata Admin e Shkallës së Parë, Lushnjë**
Norma e likuidimit (NL)	-2.2%	-10.4% (civile)-5% (penale)	-29% (civile) -10.2% (penale)	+0.25%	+1.7%
Koha e disponimit-Civile	+125%	+181.7%	+89.3%	-22.8%	+77.3%
Koha e disponimit - Penale	+10.1%	-27.8%	+130.3%	N/A	N/A
Çështjet për gjyqtar	+28.2%	+12%	+114.8%	+61.4%	-13.4%
Rastet e zgjidhura për gjyqtar	+8.9%	-4.9%	+13%	+63.2%	-28.8%
Numri i prapambetur i rasteve në fund të vitit	-25.5%	+616%	+699.7%	+430% (kundrejt mesatares)	+183.7%

[19] Shih tabelën me të dhënat statistikore për të dyja periudhat e analizuara në Aneks.

Raste të reja	-38.9%	+70.5%	+466.1%	+310% (kundrejt mesatares), +2.54% (kundrejt totalit)	+64% (kundrejt mesatares) -18.2% (kundrejt totalit)
Kostoja për numrin e rasteve	+21%	+21%	N/A	N/A	N/A

Si rezultat i analizës krahasimore të të dyja periudhave si para zbatimit të hartës dhe gjatë zbatimit të saj rezulton se nga pesë gjykatat, ndikimi i hartës së re ka çuar në ndryshime të rezultateve me rënie të tre apo më shume indikatorëve në Gjykatën e Apelit të JP, Gjykatën e shkallës së parë të JP Fier, Gjykatën administrative të shkallës së parë Lushnjë, ndërsa dy gjykatat e tjera kanë arritur rezultate pjesërisht pozitive apo mikse, ku gjykata administrative Tiranë e Shkallës së Parë ka përmirësime në katër indikatorë, ndërsa gjykata e shkallës së parë të JP Tiranë ka rezultate të pjesshme në tre indikatorë kryesore.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pasur një rritje prej 63.2% të produktivitetit për gjyqtar, duke reduktuar njëkohësisht kohën e disponimit të çështjeve me 22.8%. Në të njëjtën kohë ka pasur një nivel likuidimi të qëndrueshëm në 97.05%, ndërkohë që ka një rritje prej 430% të stokut gjyqësor krahasuar me mesataren para reformës. Rritja e kërkesës gjyqësore të përdoruesve prej 310% të rasteve të regjistruara, në krahasim me mesataren e mëparshme tregon se rritja e distancave gjeografike për katër rrethet e mëparshme, për shkak të mbylljes së gjykatave nuk ka dobësuar kërkesën gjyqësore. Nga takimi i realizuar me kryetarin e kësaj gjykate për të diskutuar mbi gjetjet e raportit, u referua se juridiksioni administrativ ka në objekt gjykimi mosmarrëveshje që lidhen me institucionet publike, të cilat janë më së shumti të centralizuara në Tiranë. Po ashtu vend ndodhja e gjykatës bashkuese në Tiranë duket sikur i ka lehtësuar qytetarët e Tropojës, Kukësit të cilët e kanë më të thjeshtë udhëtimin në Tiranë sesa në Shkodër. Një fakt pozitiv është balancimi i numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë i cili arriti në 21 gjyqtarë në vitin 2026, ndërkohë që 3 vite më parë në vitin 2023, kjo gjykatë kishte 12 gjyqtarë (më e ulët se mesatarja 27 para zbatimit të hartës). Aktualisht mbetet e lartë ngarkesa e gjyqtarëve[20] e cila pas bashkimit të 4 gjykatave, ka integruar ngarkesën e gjykatave të mëparshme. Një aspekt që mund të lehtësojë gjykatën në të ardhmen, është shtimi i ambienteve në godinën aktuale ose në një godinë të re me më shumë salla gjykimi (nga 4 aktualisht) që të mund të përballojë dhe shtimin e stafit gjyqësor, i nevojshëm për të balancuar ngarkesën e gjyqtarëve në ritme më të pranueshme se aktualisht. P.sh shqetësuese është fakti se seancat paraprake në këtë gjykatë zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.

Në kontrast, modeli i Gjykatës së vetme të JP tregon se bashkimi i gjashtë gjykatave të apelit në një gjykatë të vetme ka rritur në mënyrë shqetësuese numrin e stokut me 699.7% në 2024, në 36,535 çështje të prapambetura, nga 4,569 të tilla para hartës së re. Duke operuar me vetëm 36% të kapacitetit gjyqësor (28 gjyqtarë efektivë, nga 78 pozicione të parashikuara në organikë), gjykata po përballon një ngarkesë të lartë çështjesh për gjyqtar, prej 1,924.65, dyfish më shumë se ngarkesa para reformës së hartës. Pavarësisht rritjes së produktivitetit individual të gjyqtarëve me 13%, ata përballen me vakancë stafi në masën 61.4%. Koha mesatare e disponimit për çështjet civile ka një rritje në 2,787 ditë, që është ekuivalente me 5.6 vjet, duke

[20] Aktualisht ngarkesa për gjyqtarë në këtë gjykatë eshtë më e lartë se minimum i përcaktuar me vendim të KLGJ-së (200 për rastet me palë kundërshtare dhe 150 për rastet pa palë), respektivisht 350-500 për raste me palë kundërshtare dhe 400 për raste pa palë kundërshtare.

tejkaluar afatin proceduralo ligjor prej 730 ditësh për kohëzgjatjen normale të rasteve gjyqësore. Kjo situate dëshmon shkelje evidente të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila vihet re edhe për çështjet penale që me një kohëzgjatje mesatare pak më të mirë prej 854 ditësh, sërisht tejkalon afatet ligjore 365-ditore. Pavarësisht situatës së rënduar me tejzgjatjen e procedurave, bashkimi i 6 gjykatave të apelit në 1 nuk e ka ulur kërkesën gjyqësore të përdoruesve e cila është rritur 64% kundrejt mesatares para zbatimit të hartës, pavarësisht barrierave gjeografike të qytetarëve. Gjithsesi kjo kërkesë ka një ulje 18% krahasuar me numrin e rasteve të regjistruara të integruara të 6 gjykatave të mëparshme. Ndërkohë për periudhën pas vitit 2024, nga takimi me kryetaren e gjykatës mbi gjetjet e raportit është konfirmuar se ka një krizë të kapacitetit gjyqësor edhe pse aktualisht, stafi i gjykatës është shtuar me 10 gjyqtarë dhe me ndihmës ligjorë. Rrjedhimisht, kjo Gjykatë ka 40 gjyqtarë nga 78 pozicionet për gjyqtarë të miratuara në organikën e saj. Në tërësi, vakancat kanë sjellë rëndimin e numrit të stokut, i cili në vitin 2025 është rritur afërsisht 45,000 raste, rreth 3,000 raste më shume nga viti i kaluar. Ndërsa në vitin 2026 numri i shqyrtimit të çështjeve për gjyqtar është përmirësuar, ngarkesa e punës për çdo gjyqtar mbetet dukshëm mbi kapacitetin normal, duke treguar boshllëqe në kapacitetet me burime njerëzore që duhet të adresohen.

Kufizimet fizike të ndërtesës së gjykatës ndërlikojnë më tej problemet e vakancave të personelit, me ndihmës ligjorë që aktualisht punojnë në objekte me qira, të ndara nga gjykata kryesore. Planet për një ndërtesë të re të gjykatës së apelit janë ende në diskutim në Ministrinë e Drejtësisë dhe synohet të përfundojnë deri në vitin 2030, edhe pse nuk ka afate kohore të caktuara. Zyrat ekzistuese të informacionit të ngritura në gjykatat e mbyllura, që kanë rreth tre veta staf administrativ, vlerësohet se kanë rezultuar joefektive, duke kontribuar më shumë në shtimin e kostos së burimeve njerëzore sesa në rritjen e aksesit në drejtësi.

Në lidhje me tejkalimin e afateve kohore rreth 6-8 vite, rezulton se gjykata operon me planifikim vjetor të çështjeve që janë për shqyrtim, ne raport me kapacitetet gjyqësore të saj. Sipas konfirmimit nga ana e kryetares, çështjet e planifikuara i respektojnë afatet në mënyrë optimale, duke patur parasysh kapacitetin gjyqësor të saj nën organikën e miratuar. Ndërkohë që çështjet në fondin e stokut datojnë që nga viti 2018, masa të tjera shtesë janë të nevojshme për të ardhmen për të zgjidhur këtë situatë kritike që rëndohet vit pas viti, si: fuqizim i mëtejshëm i kapaciteteve gjyqësore, zbatimin i mjeteve digjitale për seanca dëgjimore në distancë, lehtësira për krijimin e ambienteve të duhura në godinën e gjykatës, shtimin e sallave të gjykimit, zyra të mjaftueshme për ndihmësat gjyqësore, zyra për arkivimin e dosjeve, shqyrtimin në dhomë këshillimi për çështje që kërkojnë verifikimin e shkaqeve të ankimit (Neni 35 i Kodit Civil dhe neni 426 i Kodit Penal), rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë, qoftë me status të përhershëm apo ad -hoc, deri në plotësimin e vakancave gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë të JP Tiranë arriti përmirësime modeste me një rritje të produktivitetit prej 8.9% dhe një reduktim të stokut prej 25.5%. Megjithatë, koha e disponimit të çështjeve civile u rrit me 125%, çfarë tregon se ndërsa gjyqtarët kanë përballuar ngarkesë me zgjidhje më të lartë çështjesh individualisht, ka pasur vonesa mesatarisht 269 ditë për rastet civile, të cilat nuk e tejkalojnë afatin ligjor. Rënia prej 38.9% e rasteve të reja krijon shqetësim për barrierat e kërkesës gjyqësore për ish-përdoruesit e gjykatës së Krujës me të cilën kjo gjykatë është bashkuar. Nga takimi me stafin e gjykatës, u sqarua se rritja e ngarkesës dhe produktivitetit gjyqësor, pavarësisht rënies së kërkesave gjyqësore, i atribuohet kryesisht rritjes së numrit të gjyqtarëve dhe përmirësimit të performancës gjyqësore, veçanërisht për rastet e kthyera nga gjykatat e apelit. Megjithatë, ngarkesa mesatare e punës prej 928 çështjesh për gjyqtar është e konsiderueshme, duke diktuar nevojën për më shumë staf gjyqësor, përfshirë si gjyqtarë, ndihmës ligjore ose sekretarë gjyqësorë. Gjykata kryesisht merret me çështje

komplekse civile, ku çështjet penale përbëjnë një pjesë më të vogël të ngarkesës së përgjithshme të punës. Bashkimi i gjykatave të Tiranës dhe Krujës ka rezultuar në një ulje të çështjeve të reja nga rreth 51,000 në 37,000, por nuk e ka përkeqësuar situatën në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, pasi shtimi i rreth 2200 dosjeve nga gjykata e Krujës përfaqëson vetëm 2% të ngarkesës së Tiranës. Për të lehtësuar ngarkesën e gjyqtarëve, shtimi i stafit dhe zhvendosja e gjykatës në një godinë të re me salla të mjaftueshme gjyqi (aktualisht ka 26 salla) do të ishte e dobishme, pasi do të evitonte që gjykimet të zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, një shqetësim aktual ku 1 gjyqtar zhvillon rreth 12 seanca në ditë. Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve përmes mjeteve dixhitale, seancave dëgjimore online në të gjitha fushat ligjore dhe finalizimi me sukses i një platforme njoftimi online për lehtësimin e komunikimit me avokatët e palëve në proces, vlerësohet nga kjo Gjykatë se mund të zvogëlojë ndjeshëm ngarkesën e gjyqtarëve dhe të ndihmojë në menaxhimin efektiv të prapambetur.

Gjykata e Shkallës së Parë të JP Fier ka ndeshur vështirësi edhe më të theksuara, me rritje prej 181.7% të kohës së disponimit për rastet civile, si dhe gjashtëfishimin e numrit të stokut krahasuar me periudhën para reformës. Pavarësisht rritjes prej 70.5% të çështjeve të reja që tregojnë se qytetarët i kanë tejkaluar barrierat gjeografike të qasjes së saj si pasojë e suprimimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Lushnje, norma e likuidimit të gjykatës ka pësuar rënie me 10.4% për çështjet civile. Po ashtu, ulja e kohës së disponimit për çështjet penale prej 27.8% dëshmon se ndikimi i hartës varion sipas llojit të rasteve brenda të njëjtës gjykatë. Këto të dhëna janë konfirmuar dhe nga takimi me kryetarin e kësaj gjykate për të diskutuar gjetjet e raportit. Dukshëm, rastet penale kanë një ecuri më të mirë sesa rastet civile pasi dhe prokuroria pranë kësaj gjykate ka një normë të lartë likujdimi të rasteve. Aktualisht, gjykata mban një staf gjyqësor prej 15 gjyqtarësh. Megjithatë, ngarkesa e punës është rritur në mënyrë tejet të lartë, duke çuar në kushte të vështira pune, ku gjyqtarët punojnë me orare të tejzgjatura, për të menaxhuar deri në 940 çështje civile dhe 850 çështje penale në vit. Çdo gjyqtar po trajton rreth 20-22 gjyqe në ditë, gjë që thekson nevojën urgjente për rritje të numrit të gjyqtarëve dhe staf ndihmës ligjor. Infrastruktura e gjykatës është e papërshtatshme, pasi nuk ka ambientet e duhura për zyrat e gjyqtarëve, të cilat shpesh ndahen midis dy ose tre gjyqtarëve, duke krijuar mungesa shqetësuese të hapësirës normale dhe dobësojnë standartet e pavarësisë së gjyqtarit. Për më tepër, sistemi arkivor është i decentralizuar, me arkiva të shpërndara në tre ndërtesa (një pjesë në zyrën e informacionit Lushnjë, dhe një pjesë tjetër në gjykatën e apelit), duke rezultuar në rreth 8000 dosje arkivore në vit. Megjithëse sistemi i menaxhimit të çështjeve SIMC ofron disa shërbime elektronike të të dhënave, nuk arrin të regjistrojë seancat paraprake dhe kërkon përpunim manual të statistikave. Bashkimi i gjykatave, që solli transferimin e dy gjyqtarëve nga gjykata e Lushnjës, secili me rreth 280 dosje në vit, ka rënduar më tepër Gjykatën e Fierit, e cila kishte mungesë të stafit për shkak të efektit të vettingut dhe transferimeve/komandimeve të shpeshta që e kanë ulur numrin e gjyqtarëve nga mesatarisht 11 në 7 (ndonjëherë duke arritur edhe në 5 gjyqtarë). Ky reduktim ka zgjatur kohën e disponimit të rasteve, veçanërisht problematike për çështjet civile, pavarësisht se gjykata sipas përfaqësuesve të saj arriti të zgjidhë rreth 80% të çështjeve brenda afateve të arsyeshme. Kushtet e sigurisë në gjykatë rrezikohen pasi pikat e hyrjes për stafin, të burgosurit dhe publikun nuk janë të ndara siç duhet. Si përfundim, për këtë gjykatë vlerësohet e nevojshme një rritje të personelit gjyqësor (gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë) si dhe përmirësim të kushteve të godinës, ose zhvendosjes në një godinë tjetër për të adresuar ngarkesën e punës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje pasqyron një realitet paksa të ndryshëm, si e vetmja gjykatë e krijuar rishtazi, përmes shkrirjes së dy gjykatave administrative të shkallës së parë të Gjirokastrës dhe Vlorës. Sipas efekteve për matjen e treguesve të efiçencës rezulton se gjatë viteve 2023-2024 ka pasur një rritje të kohës së disponimit prej 77.3% në këtë gjykatë,

rënie të produktivitetit prej 28.8% të rasteve të zgjidhura për gjyqtar, si dhe rritje të stokut prej 183.7%. Po ashtu, vërehet se numri i rasteve të regjistruara pas shkrirjes së gjykatave, krahasuar me totalin e integruar të gjykatave të Gjirokastrës dhe Vlorës ka rënë prej 18.2%. Nga një takim me zëvëndëskryetarin dhe kancelaren e kësaj gjykate, u diskutuan një sërë faktorësh që kanë pasur ndikim në performancën e gjykatës Lushnjë gjatë këtyre dy viteve, si koha afro prej 10 ditësh, për transferimin e e arkivave, personelit dhe pajisjeve nga gjykatat e mëparshme, infrastruktura e godinës e cila mund të akomodojë mjaftueshëm stafin nga të dyja gjykatat, me katër salla gjyqi. Nga Gjykata e Gjirokastrës u transferuan dy gjyqtarë, ndërsa Gjykata e Vlorës transferoi tetë gjyqtarë dhe dymbëdhjetë sekretarë gjyqësorë. Megjithatë, transferimi i gjyqtarëve në gjykata të tjera krijoi vështirësi në shpërndarjen e ngarkesës së punës, ku deri në vitin 2024, Gjykata e Lushnjës kishte dhjetë gjyqtarë. Për të adresuar këto sfida, tetë gjyqtarë të sapo diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës u emëruan në këtë gjykatë, megjithëse ata do të kërkojnë një periudhë prove përpara se të trajtojnë një ngarkesë çështjesh të ngjashme me atë të gjyqtarëve me përvojë. Dy zyra administrative janë ngritur në ish-gjykatat e Gjirokastrës dhe Vlorës për të zbutur distancën gjeografike, duke përpunuar përkatësisht 400 dhe 2,000 veprime administrative secila. Afërsisht 60% e ngarkesës së gjykatës përbëhet nga raste të regjistruara nga ish Gjykata Administrative e shkallës së parë Vlorë, me çështje dukshëm më shumë krahasuar me bashkitë e tjera (10 nga Lushnja dhe 2 nga Kuçova). Gjykata po përballon kosto të larta që lidhen me dërgimin e dokumenteve me postë nga zyrat administrative, veçanërisht ajo në Vlorë, e cila kontribuon në 60% të totalit të shpenzimeve. Po ashtu, ekziston një kërkesë urgjente për të krijuar një regjistër të adresave për përfaqësuesit ligjorë. Megjithë vështirësitë fillestare, Gjykata po menaxhon një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës së saj të punës, që përfshin raste që kanë të bëjnë kryesisht me vendosjen e gjobave të shkeljeve të trafikut, çështjet e ndërtimit të paligjshëm, mosmarrëveshjet mbi urdhrat e ekzekutimeve dhe korrigjimet e të dhënave të gjendjes civile. Veçanërisht, mos regjistrimi i veprimeve administrative në sistemin SIMC bën që të mos reflektohet realisht ngarkesa e gjykatës, e cila rëndohet kryesisht nga veprimet administrative. Sfidat me të cilat përballen grupet vulnerabël si të moshuarit, gratë dhe fëmijët në lidhje me qasjen në gjykatë lehtësohen disi pasi procedurat administrative nuk kërkojnë gjithmonë pjesëmarrje fizike në gjykatë, duke siguruar që gjykimet të mos ngecin nga mosparaqitja e palëve. Për më tepër, një rënie e kërkesës gjyqësore midis viteve 2023 dhe 2024, sipas zëvendës kryetarit të saj mund t'i atribuohet konsolidimit të praktikës gjyqësore. Megjithatë, kufizimet gjeografike që vijnë si pasojë e distancave prej 145 km, së bashku me kohën e udhëtimit që varion nga 2 deri në 4 orë nga Gjirokastra dhe qytete të tjera, paraqesin një situatë që ia vlen të studiohet më tej përmes sondazheve për të kuptuar efektin e tyre në uljen e kërkesës gjyqësore të gjykatës Lushnjë.

Si konkluzion mund të nënvizohet se gjykatat e shkallës së parë të JP Tiranë dhe Fier kanë rritje prej 21% të kostos për çështje të zgjidhur. Rënia e kohës së disponimit ka qenë evidente në katër nga pesë gjykata (Tiranë +125%, Fier +181.7%, Apeli +89.3% për rastet civile dhe +130% për rastet penale, si dhe Lushnja +77.3%), që ka shoqëruar si pasojë uljen e produktivitetit të këtyre gjykatave. Rënia e kërkesës gjyqësore në tre gjykata (Tiranë -38.9%, Apeli -5.6%, Lushnjë -18.2%) ngre pikëpyetje se reforma e hartës së re ka ndikuar dhe në krijimin e faktorëve dekurajues të regjistrimit të rasteve përmes distancave të shtuara të udhëtimit.

Krahasimi në rang rajonal dhe evropian: Performanca e përpunimit të rasteve civile të Shqipërisë në rang kombëtar sipas raportit të KEED (2024) është 377 ditë, çfarë tejkalon ndjeshëm mesataren e Këshillit të Evropës prej 239 ditësh. Mali i Zi përpunon rastet civile në 417 ditë (në mënyrë të ngjashme problematike), ndërsa Serbia arrin 299 ditë, dukshëm më mirë

se Shqipëria. Përpunimi i rasteve administrative në 179 ditë nga ana e Shqipërisë përfaqëson përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2022.

Koha e Disponimit			
	Penale	Civile	Administrative
Estonia	**36**	**158**	**166**
Hungaria	**44**	**134**	**125**
Lituania	**73**	**116**	**79**
Shqipëria	**93**	**377**	**179**
Mali i Zi	**313**	**417**	**1,180**
Serbia	**NA**	**299**	**1,528**
Mesatarja Europiane	**157**	**273**	**396**

Shqipëria tregon përmirësim të konsiderueshëm në lidhje me normën e disponimit për rastet penale 93 ditë, e cila është poshtë mesatares evropiane dhe më mirë në krahasim me treguesit rajonalë. Rastet administrative me një normë të KD 179 ditë tregojnë po ashtu parametra më të mirë se Serbia dhe Mali zi, por më pak efikas se Estonia, Hungaria. Pavarësisht kësaj, KD për rastet civile 337 ditë mbetet më e ngadaltë krahasuar me mesataren evropiane 273 ditë, dhe 2-tre herë me e ngadaltë se normat e Estonisë dhe Hungarisë.

Pabarazi gjeografike: Rënia e rasteve të reja të regjistruara në gjykata të caktuara, veçanërisht e dukshme në gjykatën administrative të Lushnjës (nga 3110.3 raste të reja në 2521.5 raste), në Gjykatën e Apelit të JP Tiranë (nga 15046.7 raste në 14197) dhe në gjykatën e JP të rrethit Tiranë (nga 53614.3 raste të reja në 32,706 raste në periudhën pas zbatimit të hartës) , ngre pikëpyetje nëse reforma krijoi një sistem me dy nivele ku disa qytetarë sidomos ato në qendrat urbane kanë përfituar nga zbatimi i hartës së re në drejtim të afërsisë gjeografike me gjykatat, ndërsa disa të tjerë sidomos ato në zonat rurale dhe periferike janë përballur me distanca të largëta gjeografike rrjedhimisht me akses akoma më të reduktuar në drejtësi.

Kjo situatë pabarazie në lidhje me distancën gjeografike disproporcionale të përdoruesve të gjykatave, me efekt më të ndjeshëm në të vetmen Gjykatë të Apelit të JP cenon parimet e trajtimit të barabartë që janë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas nenit 14 të KEDNJ. Procedurat pranë gjykatave të ri-organizuara tashmë imponojnë barrë ekstra financiare për përdoruesit që kanë patur afërsi gjeografike me gjykatat e shkrira, përmes tarifave ligjore dhe shpenzimeve të lidhura me to duke vështirësuar ushtrimin e mjeteve juridike për sipas nenit 13 të KEDNJ-së. Këto barriera ndikojnë në mënyrë disproporcionale popullatat rurale, individët me të ardhura të ulëta dhe ato me aftësi të kufizuara, duke cënuar të

drejtën për të mos u diskriminuar, të garantuar nga neni 1 i Protokollit 12 të KEDNJ. Krijimi i zyrave administrative të informacionit ofron një zbutje të kësaj situate kritike në gjykatat administrative, për shkak të juridiksionit më pak kompleks të këtyre gjykatave, por nuk mund të zëvendësojë plotësisht zgjidhjen e aksesit të drejtpërdrejtë të gjykatës për procedura që janë më komplekse ose për çështje të natyrës urgjente në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

Distancat e largëta mund të vështirësojnë mbrojtjen e duhur të qytetarëve, nisur nga fakti se avokatët që udhëtojnë për të marrë pjesë në një seancë gjyqësore mbi më shumë se 8 orë, nuk arrijnë të marrin kohën e duhur për përgatitjen e mbrojtjes para gjykatës, siç u evidentua në një vendim të GJEDNJ-së[21] "*Makhfi k. France*", ky kjo gjykatë konstatoi shkelje të standartit të procesit të rregullt ligjor, pikërisht për shkak të efektit të hartës gjyqësore. Për një vend si Shqipëria ku 49% e popullatës është në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta, mbrojtja ligjore e tyre në gjykata është trajtuar si tepër problematike sipas informacionit të marrë nga Avokati i Popullit. Ndërsa Shqipëria ka rritur rastet e ndihmës ligjore nga 270 në vitin 2019 në 7,737 në vitin 2023, shpërndarja e buxhetit për këtë qëllim mbetet e kufizuar në 26-euro për banor dhe nuk i përgjigjet nevojave të gjera të shtetasve në nevojë dhe pamundësi ekonomike.

Mungesa e mjeteve digjitale të gjykimit në zonat e largëta si kompensim për barrierat gjeografike: Në këtë situatë, përdorimi i mjeteve dixhitale për zhvillimin e procedurave gjyqësore "*online*" si dhe për marrjen e disa shërbimeve gjyqësore në rrugë elektronike do ishte një kërkesë e nevojshme por e zbatuar në mënyrë të kujdesshme që të mos krijojë pabarazi, për njerëz në nevojë që nuk kanë akses në këto mjete apo njohuri për përdorimin e tyre. Nga informacioni i siguruar përmes KLGj dhe gjykatave respektive rezulton se ka një nivel bazik të digjitalizimit dhe modernizimit teknologjik. Vetëm Gjykata e JP e shkallës së parë Tiranë po zbaton një projekt pilot për njoftimin elektronik të dokumenteve për avokatët, ndërsa të gjitha gjykatat disponojnë vetëm forma bazë elektronike për kërkesat e dokumenteve. Ndërsa ka një strategji që është duke u zbatuar për vendosjen e SIMC (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve) për të gjitha gjykatat, kjo iniciativë mund të ndihmojë më shumë administrimin e brëndshëm të gjykatave, por nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në lehtësimin e komunikimit të gjykatave me përdoruesit e saj.

Efektiviteti i kostos: koefiçienti i kostos për rastet e zgjidhura të gjykatave ka pësuar ndryshime të ndjeshme në të gjithë gjykatat dhe juridiksionet. Ndërsa disa nga gjykatat arritën përmirësime modeste, të gjitha gjykatat e monitoruara treguan rritje në koefiçientin e kostos për rastet e zgjidhura[22]: Tirana (+21%), Fier (+21%), Gjykata e Apelit (+89%), Gjykata administrative Tiranë (+18%).

Gjykata	Para hartës së re Kosto/raste të zgjidhura	Pas hartës së re Kosto/raste të zgjidhura	Ndryshimi (%)
JP Shkalla Parë, Tiranë	16,888 lek	20,439 lek	+21%
JP Shkalla e Parë, Fier	14,661 lek	17,800 lek	+21%
JP i apelit Tiranë	26,963 lek	50,924 lek	+89%

[21] Makhfi k. Francës (N° 59335/00), Vendimi I GJEDNJ-së datë 19.10.2004 ,Seksioni i II]
[22] Vlerat përllogariten duke pjesëtuar koston e secilës gjykatë në raport me numrin e çështjeve të zgjidhura në vit.

Admin, Shkalla e parë Tiranë	15,274 lek	18,065 lek	+18%
Admin, Shkalla e Parë Lushnjë	-	21,861 lek	-

Këto rritje në kosto shpjegojnë ndryshimin vetëm në raport me gjykatën bashkuese, por nuk marrin në konsideratë vlerën e kombinuar të kostot të gjykatës me gjykatat e mëparshme para hartës së re. Kjo për shkak se për këtë periudhë 2020-2022 kërkohen të dhëna të kombinuara për koston e gjykatave.[23]

Implikimi i standartit për kohëzgjatje të arsyeshme sipas nenit 6 të KEDNJ-së: Gjykata e shkallës së parë të JP Tiranë, pas bashkimit të saj me gjykatën e Krujës ka pasur rritje të disponimit në kohë të çështjeve 125.9% për rastet civile dhe 9.9% për rastet penale. Gjykata e shkallës së parë të JP Fier pas bashkimit me gjykatën Lushnjë ka pasur një rritje 181% të kohës së disponimit për rastet civile dhe reduktim të kohës së gjykimit për rastet penale në 27.8. Gjykata e apelit e JP Tiranë ka pasur rritje 89% për kohën e disponimit për rastet civile (1,472.3 në 2,787) dhe mbi 130% rritje për rastet penale (370.7 në 854).[24] Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas bashkimit të katër gjykatave të mëparshme, reduktoi kohën e gjykimit të rasteve në 208 ditë rreth 22.8% krahasuar me mesataren para miratimit të hartës që ishte 269.5 ditë[25]. Ndërsa për gjykatën administrative Lushnjë ka pasur një rritje të kohës së disponimit për rastet 77% (nga 152.3 në 269.5). Nga këto gjetje figuron se situata është më shqetësuese në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, e cila tejkalon afatet ligjore të gjykimit për rastet civile dhe penale të përcaktuara në nenin 399.2/b, d të Kodit të Procedurës Civile. Për më shumë detaje mbi normën e disponimit në kohë të rasteve për gjykatat në të dyja periudhat, tabela më poshtë:

Gjykata	**Mesatarja e kohës së disponimit 2020-2022**	**Mesatarja e kohës së disponimit 2023-2024**	**Analiza e situatës sipas përqindjes së ndryshimit**
Gjykatat e rretheve			
Gjykata e shkallës së parë të JP, Tiranë	**Gjykata Tiranë 238.6/138.3 : 106.3/58 + Gjykata Krujë: 132.3/80.3**	**269.5/76**	**▲ Rritje e ndjeshme (~154% civile / ~31% penale)**

[23] Kështu këto vlera duhet të përfshijnë koston e gjykatës Krujë në rastin e gjykatës së rrethit Tiranë; koston e gjykatës Lushnjë për vlerën e kombinuar për gjykatën e rrethit gjyqësor Fier; koston e kombinuar të 6 gjykatave të mëparshme të apelit; koston e kombinuar të gjykatës administrative Tiranë me 3 gjykatat e tjera administrative Korçë, Shkodër dhe Durrës.

[24] Duke e llogaritur si mesatare të DT për secilën gjykatë apeli: Tirana (5,301.6/983.3 ditë), Durrësi (787.6/260.6), Gjirokastra (255/113), Korça (978/216.6), Shkodra (598/216.3), dhe Vlorë (914/365.6)

[25] E llogaritur si mesatare e gjykatave të mëparshme: 109.3 (Tiranë), 683.3 (Durrës), 270.3 (Shkodra) dhe 15.6 (Korçë).

Gjykata	Mesatarja e kohës së disponimit 2020-2022	Mesatarja e kohës së disponimit 2023-2024	Analiza e situatës sipas përqindjes së ndryshimit
Gjykata e shkallës së parë të JP, Fier	196.3/98.3 Fier: 106.3/58 + Lushnja: 90/40.3	276.5/35.5	▲ Rritje e lartë (~160% civile/ ▼ 39% penale)
Gjykata e Apelit			
Gj e Apelit të JP Tiranë	Totali 8,915.2/2,043.8/6 = Mesatarja 1485.8/340 Tirana: 5,301.6/983.3 + Durrës: 787.6/260.6 + Gjirokastër: 255/113 + Korçë: 978/216.6 + Shkodër: 598/285.3 + Vlorë: 914/365.6	2737/854	▲ Civile: +84% rritje (1,485.8 në 2,737) ▲ Penale: +151% rritje (340 në 854) Koha e disponimit është rritur ndjeshëm
GJYKATAT ADMINISTRATIVE			
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë	Totali 1,078.5 /4 = Mesatarja 269.6 Tirana: 109.3 + Durrës: 683.3 + Shkodër: 270.3 + Korçë: 15.6	208	▼ Përmirësim 12% (269.6 në 208) Rritje e efikasitetit e ndjeshme krahasuar me mesataren e 4 gjykatave të mëparshme
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Lushnje	Totali 304.6 /2= Mesatarja 152.3 Gjirokastër: 55.3 + Vlorë: 249.3	269.5	▲ 77% rritje (152.3 në 269.5) Rënie e performancës krahasuar me mesataren e dy gjykatave të mëparshme

Kjo situatë kritike për kohën e disponimit të Gjykatës së Apelit të JP sjell pasoja në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut. Sipas Avokatit të Popullit, pjesa më e madhe e rasteve të zvarritjeve në gjykatën e JP të Apelit Tiranë vijnë për shkak të mos arsyetimit të vendimit, çfarë mund të zgjasë deri në 11 vite siç është konstatuar në një rast. Pavarësisht se në përfundim të

çështjeve penale përgjithësisht jepet "shkurtim vendimi", nuk ofrohet analizë ligjore dhe as analizë provash, e për pasojë nuk përmbushet standardi kushtetues i ligjshmërisë që të mbështesë pjesën urdhëruese apo dispozitivin e vendimit gjyqësor. Po ashtu problematike paraqiten rastet për zgjidhjet e martesës, çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, çështjet që kanë të bëjnë me dhënien e masave të sigurisë etj. Nga informacioni i Avokatit të Popullit rezulton se gjatë vitit 2024 janë trajtuar gjithsej 146 ankesa të kësaj natyre, për të cilat janë adresuar rekomandimet[26] përkatëse ndaj gjykatave, sidomos ndaj Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ndërsa në dy rekomandime të Avokatit të Popullit që i janë adresuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm[27]janë konstatuar vonesa që lidhen me mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Po ashtu, sipas këtij institucioni veçanërisht problematike paraqitet situata për zvarritjen e rasteve penale, ku individët mund të mbeten në paraburgim ose nën masa sigurimi, në pritje të konfirmimit dhe zbardhjes së vendimit nga gjykata e apelit. Sipas diskutimeve në disa Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, këto zvarritje shpjegohen si pasojë e mbingarkesës së gjyqtarëve me çështje, mungesës së gjyqtarëve të larguar nga reforma në drejtësi (*Vettingu*)[28] dhe për shkak të riorganizimit të gjykatave të apelit në një të vetme që funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo situatë kritike implikon të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor, si një standard kushtetues i garantuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në përqasje të plotë me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.[29] Në lidhje me këtë problematikë ka një praktikë të konsoliduar me vendime të gjykatave më të larta (Gjykatës së Lartë[30] dhe Gjykatës Kushtetuese),[31]si dhe vendime të GJEDNJ-së.[32]

7. Rekomandime

Ri-organizimi gjyqësor, veç barrierave që krijoi për përdoruesit e gjykatave në kushteve të vështira sociale dhe ekonomike si rrjedhojë e thellimit të distancave gjeografike për shkak të suprimimit dhe shkrirjes të 16 gjykata, gjithashtu u përball edhe me sfida të tjera si pamjaftueshmëria e ambienteve dhe kushtet e vështira infrastrukturore të disa prej godinave të gjykatave të cilat u ri-organizuan duke u bashkuar me gjykatat e suprimuara, vakancat në staf gjyqësor, ndihmës ligjorë, mungesë të një sistemi digjitalizimi të plotë dhe gjithëpërfshirës.

[26] 16 rekomandime në total me 22 nën rekomandime, të cilat u janë drejtuar 9 institucioneve ku përfshihen organet e drejtësisë dhe gjykatat.

[27] Lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor nr.148, datë 28.03.2022, të ish Gjykatës së Apelit Shkodër dhe tjetri për arsyetimin e një vendimi gjyqësor penal*https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Gjykates%20se%20Apelit.*

[28] *Për më tepër shih:* *https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20gjykates%20L.M.pdf* *https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20gjykates%20Shkoder%20K.R.pdf*

[29] *Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se: Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

[30] *Vendimet e Gjykatës së Lartë me nr. 38/2013 dhe nr. 84/2013; Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 12.12.2013.*

[31] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/2011.*

[32] Shih Vendimi i GJEDNj-s- për çështjen "Hadjianastassiou kundër Greqisë"

Në lidhje me këto gjetje, KShH gjen rastin të përcjellë këto rekomandime:

- I rekomandohet institucioneve përgjegjëse (KLGJ-së, MD-së) të kryejnë riorganizimin territorial të gjykatave sipas vlerësimeve të duhura dhe gjithëpërfshirëse, të cilat nuk duhet të lihen afër pragut 5 vjeçar nga miratimi i hartës ekzistuese (korrik 2022) që përkon me nevojën e ri-organizimit të radhës së sistemit gjyqësor. Ky vlerësim duhet të ketë në prioritet ndikimin që sjell harta gjyqësore tek të drejtat e njeriut.[33] Në këtë drejtim, rekomandohet të kryhet konsultim paraprak domethënës me komunitetet që mund të cënohen në çdo bashki të vendit, organizatat e shoqërisë civile, avokatë, pedagogë, etj, për të mundësuar një pjesëmarrje demokratike në vendimmarrje publike të kësaj natyre me interes të lartë publik.
- KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë ftohen të ndërmarrin masat e duhura për të propozuar rritjen e balancuar të buxhetit gjyqësor që është i domosdoshëm për fuqizimin e kapaciteteve të gjykatave me burimeve njerëzore dhe financiare, që i shërben përmirësimit të performancës së tyre sipas treguesve të efiçencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore.
- I sugjerohet KLGJ-së dhe MD-së të verifikojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse shpërndarjen e burimeve njerëzore, financiare dhe të gjithë faktorët e mundshëm për zbatimin e metodologjisë për rishikimin e hartës gjyqësore, të balancuar në raport me treguesit e efiçencës dhe cilësisë së performancës së gjykatave sipas objektivave ligjore dhe kritereve përkatëse të parashikuara në nenin 14, 15 të Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", në mënyrë të veçantë: zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë dhe vënien në përdorim të mjeteve digjitale për zhvillimin e procedurave të gjykimit në distancë, barrierat gjeografike dhe të transportit sidomos për kategori të caktuara të përdoruesve të gjykatave, siç janë personat më vulnerabël, të disavantazhuar ekonomikisht, si dhe personat që vuajnë dënimin në IEVP për të cilët kërkohen masa ekstra transporti dhe sigurie.
- Institucionet përgjegjëse si KLGJ dhe këshillat respektive të gjykatave ftohen të ndërmarrin masa afat shkurtër dhe afatmesme për zgjidhjen e situatës emergjente të krijuar në gjykatën e Apelit të JP Tiranë, po ashtu dhe gjykatën e shkallës së parë të JP Fier dhe gjykatën e shkallës së parë të JP Tiranë, për krijimin e mekanizmave të duhur sipas nenit 94, pika 4 e Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" që synojnë përmirësimin e standarteve të eficencës në praktikën gjyqësore sipas udhëzimeve të KEEDSIMC si: (1) standartizimi i afateve kohore për gjykimin e afateve për fazat e ndërmjetme të procedurës (seancat gjyqësore, koha e pritjes ndërmjet), duke ponderuar rastet sipas kompleksitetit, urgjencës dhe prioritetit të tyre edhe sipas jurisprudencës së GJEDNj-së, (2) krijimin e mekanizmave për menaxhimin e vonesave të krijuara në disponimin e çështjeve kur tejkalohen afatet ligjore, (3) inkurajimin e stafit gjyqësor dhe jo gjyqësor për një rol aktiv për menaxhimin e rasteve, (4) krijimin e mekanizmave për zgjidhjen e çështjeve funksionale dhe shpërndarjen e balancuar të ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave.
- I rekomandohet Ministrisë së Drejtësisë të avancojë më tej projektin për godinën e re të gjykatave të vendosura në Tiranë, për ti dhënë një zgjidhje situatës kritike të hapësirave të pamjaftueshme, sidomos në gjykatën e Apelit të JP Tiranë, po ashtu të sigurohet një zgjidhje për godinën e gjykatës së shkallës së parë të JP, Fier.

[33]Që të evitohen shkeljet e KEDNJ-së, sidomos për të drejtën e barazisë para ligjit (neni 14), mosdiskriminimit (neni 1 Protokolli 12), të drejtën për mjete efektive (neni 13), si dhe të drejtën për akses në gjykatë dhe një kohëzgjatje të arsyeshme të proceseve gjyqësore (nenin 6).

- I rekomandohet KLGJ-së në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të ndërmarrin masat e duhura për propozimin e numrit të duhur të stafit gjyqësor (përfshirë dhe ndihmësat dhe sekretarët gjyqësore), sidomos për gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, për gjykatat e shkallës së parë të JP Tiranë dhe Fier si dhe për gjykatën administrative të shkallës së parë në Tiranë.

ANEKS 1

Dialogu me palët e interesuara mbi reformën e hartës gjyqësore në tryezën e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në datë 20.02.2026

Prezantimi i draftit të studimit mbi reformën e hartës gjyqësore krijoi një dialog thelbësor midis krerëve dhe përfaqësuesve të institucionet e drejtësisë dhe gjykatave të përfshira në këtë studim në Shqipëri, duke nxjerrë në pah një konsensus si për sfidat e identifikuara ashtu edhe për rrugën përpara.

Znj. Cinzia Taletti, përfaqësuese e programit për Sundimin e Ligjit të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë hapi diskutimin duke theksuar rëndësinë kritike të të kuptuarit të shkaqeve rrënjësore të ngadalësimit të gjykimit të rasteve. Ajo theksoi se ndërsa efektet e zbatimit të hartës janë domethënëse, ato duhet të shqyrtohen së bashku me faktorë të tjerë rëndues, si akumulimi i rasteve te prapambetura dhe kompleksiteti i rasteve sipas tipologjive të tyre, efektet e korrupsionit ne vendimmarrje etj. Znj. Taletti inkurajoi palët e interesuara të konsiderojnë zgjidhje alternative për zgjidhjen e çështjeve, veçanërisht ndërmjetësimin, si një mjet për të lehtësuar presionin mbi sistemin gjyqësor.

Ministri i Drejtësisë u angazhua me të gjitha gjetjet e paraqitura në raport, duke pranuar sfidat dhe duke propozuar reforma konkrete strukturore. Më e rëndësishmja, ai theksoi kërkesën urgjente për të rishikuar modelin e Gjykatës së vetme të Apelit të JP, duke sugjeruar një riorganizim të ri që do të krijonte tre gjykata rajonale (përveç Tiranës në veri dhe jug), ose një zgjidhje alternative të plotësimit të gjykatës së Apelit Tiranë me tre degë, në vend të gjykatës se vetme të apelit që është e centralizuar. Ministri parashtroi një vizion të reformës së suksesshme që shkon përtej konsolidimit gjeografik për të adresuar organizimin funksional. Ai theksoi se gjyqtarët duhet të çlirohen nga pesha e detyrave administrative për t'u fokusuar në vendimmarrjen gjyqësore, gjë që kërkon zhvillimin e duhur të roleve të asistentëve ligjorë dhe sekretarëve të gjykatës. Duke adresuar krizën e vendeve vakante, ministri vuri në dukje se ndërsa gjykatat aktualisht funksionojnë me kapacitet 69% dhe prokuroria me 89%, narativat rreth kësaj krize priren të përqendrohen në faktorë objektivë. Megjithatë, ai sugjeroi se rrethanat subjektive gjithashtu luajnë një rol, duke zhvendosur potencialisht përgjegjësinë e gjyqtarit nga një dimension individual në një dimension kolektiv.

Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqiti një kontekst të rëndësishëm mbi shkaqet sistemike te evidentuara, duke theksuar se zbatimi i hartës gjyqësore ka hyrë në semestrin e dytë të fazës së tretë të saj. Ai shpjegoi se zbatimi është ndikuar nga faktorë të shumtë përtej vetë hartës, duke përfshirë dinamikën demografike, modelet e zhvillimit të biznesit në të gjithë vendin, madje edhe disponimin e gjykimit, i cili mund të vonohet nga zvarritja e krijuar nga vetë përdoruesit e gjykatës. Duke trajtuar në detaje krizën e vendeve vakante në sistemin e gjykatave, Kryetari i KLGJ-së përshkroi faktorë të shumtë kontribues, ku largimet e magjistratëve për shkak të vetingut mbeten të rëndësishme, me 268 magjistratë të hequr nga

sistemi. Megjithatë, ai identifikoi një problem strukturor në vetë ligjin: për shkak se asistentët ligjorë kanë të njëjtin status si magjistratët, kjo krijon vështirësi në plotësimin e pozicioneve të gjyqtarëve nga grupi i magjistratëve që diplomohen në Shkollën e Magjistraturës, pasi disa emërohen si ndihmës gjyqtarë. Një arritje në këtë drejtim është plotësimi me shumë vështirësi i pozicioneve në gjykatat e posaçme si në shkallën e parë ashtu edhe në nivelin e apelit. Por kapaciteti i përgjithshëm mbetet i kufizuar edhe për shkak të vakancave të përkohshme të krijuara nga transferimet dhe komandimet, të cilat janë të pashmangshme në sistem. Edhe fakti që shumica e anëtarëve të KLGJ-së dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë statusin e magjistratit e zvogëlon më tej kontingjentin në dispozicion për plotësimin e pozicioneve vakante. Kryetari i KLGJ-së deklaroi se nga fondet e fundit të alokuara për shtimin e 100 anëtarëve të stafit, shumica u përthith nga personeli i sigurisë, sekretarët gjyqësorë dhe stafi i ndihmësave ligjor, ndërsa pjesa e mbetur në dispozicion për gjyqtarët. Rritja e numrit të përgjithshëm të përcaktuar me ligj për gjyqtarët, do lejonte Shkollën e Magjistraturës të rriste kuotat e kandidatëve për magjistratë, progresivisht. Pavarësisht këtyre sfidave, ai theksoi një aspekt pozitiv që shpesh anashkalohet: sistemi ka arritur të mbajë norma të qëndrueshme likuidimi gjatë gjithë kësaj krize.

Kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e vërtetoi këtë vlerësim, duke konfirmuar se sistemi i prokurorisë përballet me një situatë po aq kritike me numër të lartë të vendeve të lira.

Gjyqtarja Edlira Petri, që shërben në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ofroi një perspektivë mbi krizën që prek gjykatën e apelit për shkak të një hendeku strukturor: ndërsa plotësimi i vendeve vakante në gjykatat e shkallës së parë ka përparuar me një ritëm më të shpejtë, duke arritur deri në 70% për shkak të kritereve më të lehta që lejojnë çdo magjistrat të kualifikohet, Gjykata e Apelit ka plotësuar vakancat e saj me vetëm 50% sepse gjyqtarët kërkojnë shtatë vjet përvojë profesionale. Ky hendek krijon një pamundësi objektive për gjykatën e apelit për të likujduar natyrshëm volumin e ankimimeve që vijnë nga shkalla e parë. Znj. Petri përshkroi krizën në ngarkesën e lartë të punës, duke vënë në dukje se numri i lartë i seancave gjyqësore tejkalon 21,884 seanca në vit, duke çuar në seanca të shumta të zhvilluara brenda një dite të vetme. Ajo theksoi se numrat e rasteve të prapambetura në fakt datojnë në vitin 2018, para reformës së hartës, por presioni është bërë i lartë, duke çuar në lodhje profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit. Ajo konfirmoi se zgjidhjet e duhura përfshijnë rritjen e stafit gjyqësor dhe vendosjen në zbatim të mjeteve digjitale për zhvillimin e seancave gjyqësore online. Pyetjes nëse harta aktuale ndihmon vërtet në specializimin dhe profilizimin e gjyqtarëve, ajo vuri në dukje mungesën e reagimeve konkrete nga qytetarët në zonat e largëta në lidhje me barrierat gjeografike dhe faktin se shumica e gjyqeve përfundojnë me vetëm një seancë, por gjithsesi vonesat vazhdojnë. Mungesa e infrastrukturës dhe rritja e rasteve te prapambetura, argumentoi ajo, kërkojnë një strategji konkrete për menaxhimin e kësaj krize përtej thjesht shtimit të stafit. Ajo propozoi kategorizimin e çështjeve sipas tipologjive dhe rritjen e aksesit të Gjykatës së Apelit në regjistra të ndryshëm të institucioneve publike që janë palë, gjë që do të ndihmonte në shmangien e shtyrjes së seancave për shkak të informacionit jo të plotë.

Përfaqësues nga disa gjykata përforcuan gjetjet e raportit përmes përvojave të tyre institucionale. Përfaqësuesi i Gjykatës së shkallës së parë të JP Fier theksoi kërkesën urgjente për një ndërtesë adekuate për të akomoduar gjyqtarët. Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje propozoi krijimin e një sistemi dosjesh dixhitale, duke thënë se kjo infrastrukturë do t'u mundësonte gjykatave të zhvillojnë gjykime shumë më shpejt dhe me efikasitet. Përfaqësuesi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë theksoi gjithashtu rëndësinë kritike të infrastrukturës fizike të ndërtesave dhe sistemit digjital. Pjesëmarrësit

sollën vëmendjen edhe situatën e Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Lezhës (edhe pse jo objekt i një analize të drejtpërdrejtë por e prekur nga harta e re), e cila pasqyron situatën kritike të infrastrukturës se godinës: me 11 gjyqtarë që kërkojnë hapësirë pune, ndërtesa ka vetëm 11 zyra dhe vetëm 3 salla gjyqi, duke krijuar kufizime të planifikimit te gjyqeve dhe ambiente të papërshtatshme për funksionimin e duhur gjyqësor.

Drejtuesi i Shoqatws së Prokurorëve, Z.Gëzim Spahia shprehu perspektivën nga ana prokuroriale e sistemit të drejtësisë, duke përforcuar gjetjet e raportit se zbatimi i hartës gjyqësore ishte ndoshta i parakohshëm, i ndërmarrë pa krijuar më parë kushtet e nevojshme për infrastrukturën, si ndërtesat fizike ashtu edhe sistemin digjital. Ai shpjegoi se prokurorët kryejnë rreth 300 hetime në vit, megjithatë mungesa e kushteve për marrjen në pyetje të personave me pajisje regjistrimi audio dhe mungesa e dosjeve të digjitalizuara krijojnë pengesa të konsiderueshme, duke rritur vështirësitë në menaxhimin e kohëzgjatjes së procedurave.

ANEKS 2

Tabela 1: Të dhëna per gjykatat sipas dokumentit analitik të reformës në drejtësi.

Periudha 2018-2024	Pezull në fund të vitit (Backlog)	Norma e Likujdimit (NL)	Koha e disponimit (KD)	Gjyqtarë	Vakanca	Staf admin /gjyqtar	Staf administrativ	Vakanca	Gjyqtar/ 100k banorë	Të përfundu ara/gjyqtar	Ngarkesa /gjyqtar
2018	77853	0.93	140.8	361 O	47	2.65	981 D 960 O	21	12.8	383.8	599.4
2019	92602	0.99	146.7	306 O	102	3.06	960 D 937.9 O	22.1	10.9	449.8	752.4
2020	74728	1.14	124.8	359 O 287 E[34]	49	3.09	1060 D 1046 O	14	14.5	370.9	739.07
2021	125689	0.66	201.1	329 O 224 E	79	2.58	1140 D 1030 O	110	8.6	580.8	1098.1
2022	132769	0.94	185.9	318 O 228 E	90	2.9	1187 D 1057 O	130	8.13	561.4	1144.2
2023	132,185.8	1.004	191.4	330 O 247 E	78	4.1	1207D 1034 O	173	8.8	485.05	1020.2
2024	127,687	1.03	182.8	333O 272E[35]	75	3.98	1207D 1084O	123	9.85	467.8	937.3
Total	**763513.8**	**6.694**	**1173.5**	**2336**	520	**22.36**	**7148.9**	**593.1**	**73.58**	**3299.55**	**6290.67**
Mesatare	109073.4	0.95	167.6	**333.7**	74.2	3.19	**1021.2**	**84.7**	10.5	471.3	898.6
Mesatare Evropiane						4.12			21.952		

[34] Numri i gjyqtar[ve efektivisht n[detyr[.
[35] Raporti vjetor i KLGJ-së, viti 2024.

Tabelë 2: Metodologjia për monitorimin e performanceës së 5 gjykatave për matjen e impaktit të hartës së re gjyqësore

Metodologjia	Baza Ligjore	Qasja e Zbatimit	Teknikat e Matjes	Kërkesat për të Dhëna	Procedurat e Validimit	Rezultatet e Pritura
Kuadri Kushtetues, ligjor	Ndryshimet Kushtetuese (22 korrik 2016); standartet e reja ligjore për efikasitet dhe cilësi ne administrimin gjyqsëor	Autoriteti institucional i KLGJ-së; Cikli i shqyrtimit 5-vjeçar; Kërkesa e harmonizimit evropian	Vlerësimi i përputhshmëri së kushtetuese; Vlerësimi i kapacitetit institucional	Kushtetuta; kriteret ligjore per rishikimin e hartës gjyqësore; Standardet evropiane	Verifikimi i përputhshmër isë ligjore; Konfirmimi i autoritetit institucional	Vlerësimi i efektivitetit institucional
Zbatimi i Kritereve Ligjore	Ligji Nr. 96/2016 Neni 14 (objektivat) dhe Neni 15/3 (kriteret)	Operacionalizimi i 9 kritereve specifike; Akses i balancuar në drejtësi; Ulja e kostos; Optimizimi i burimeve	Zhvillimi i treguesve sasiorë; Matja e aksesueshmëri së gjeografike; Analiza kosto-përfitim	Të dhëna të gjykatave; Informacion gjeografik; Të dhëna financiare	; Verifikimi i përputhshmër isë së kritereve dhe objektivave ligjore	Vlerësimi i arritjes së objektivave; Vlerësimi i përputhshmërisë së kritereve
Strategjia e Përzgjedhjes së Gjykatave	Selektim I gjykatave për vlerësimin e ndikimit të drejtpërdrejtë	5 gjykata të përzgjedhura: Apeli (bashkim 6→1), Qarku i Tiranës (+Kruja), Qarku i Fierit (+Lushnja), Administrata e Tiranës (4→1), Administrata e Lushnjës (2→1)	Analiza e ndikimit të ngarkesës së punës; Vlerësimi i treguesve të performancës; Vlerësimi i mbulimit përfaqësues	Raportet vjetore të KLD-së për vitin 2023; Statistikat e ngarkesës së punës së gjyqtarëve; Të dhëna shkresore nga KLGJ dhe 5 gjykatat.	Verifikimi i kritereve të përzgjedhjes; Konfirmimi i mbulimit përfaqësues	Përfaqësimi i mostrës strategjike; Vlefshmëria e matjes së ndikimit
Kuadri i Analizës Kohore	Krahasim sistematik para/pas; verifikimi I tendencave se si janë përshtatur gjykatat me zbatimin e hartës së re	Periudha 1: (2020-2022); Periudha 3: Vlerësim i zgjeruar (2023-2025)	Analiza e trajektores së impaktit të hartës; Identifikimi i ndryshimit; Vlerësimi i afatit kohor të përshtatjes	16 të dhëna para reformës; 5 të dhëna pas reformës së gjykatave;	Verifikimi i përputhshmër isë kohore;	Matja e ndikimit të reformës; Vlerësimi i suksesit të përshtatjes së gjykatave me hartën e re
Treguesit e Efikasitetit	Kërkesat për optimizimin e performancës;	Matja e menaxhimit të ngarkesës së çështjeve; Llogaritja e raportit të produktivitetit; Vlerësimi i	Çështjet për gjyqtar; Normat e zgjidhjes; Kostoja për çështje; Raportet e stafit;	Statistikat e çështjeve gjyqësore; Të dhënat e personelit; Të dhënat financiare;	Verifikimi i saktësisë statistikore; Konsistenca e metodologjisë së llogaritjes	Matja e përmirësimit të efikasitetit; produktimitetit;ndikimi tek te drejtat e njeriut;

Metodologjia	Baza Ligjore	Qasja e Zbatimit	Teknikat e Matjes	Kërkesat për të Dhëna	Procedurat e Validimit	Rezultatet e Pritura
		efikasitetit të burimeve	Shfrytëzimi i buxhetit	Raportet e performancës		
Treguesit e Cilësisë	Mandati për përmirësimin e cilësisë së shërbimit; Kërkesat për kënaqësinë e qytetarëve	Cilësia e zgjidhjes së çështjeve; Vlerësimi i ofrimit të shërbimeve; Vlerësimi i integrimit të teknologjisë	Normat e apelimit/kthimit; Konsistenca e kohës së përpunimit; Disponueshmëria e shërbimit dixhital; Aftësia e aksesit të qytetarëve	Të dhënat e cilësisë së çështjeve; Statistikat e vendosjes së teknologjisë; Informacion mbi disponueshmërinë e shërbimit	Validimi i matjes së cilësisë; Verifikimi i ofrimit të shërbimeve	Vlerësimi i përmirësimit të cilësisë së shërbimit; Matja e kënaqësisë së qytetarëve
Analiza e Stafit	Kriteret për optimizimin e burimeve njerëzore; Kërkesat për kapacitetin gjyqësor	Vlerësimi aktual i stafit (408 gjithsej, 389 aktivë, 79 vende të lira); Integrimi i planifikimit strategjik; Vlerësimi i ndikimit të verifikimit	Raportet staf-gjyqtar; Analiza e normës së vendeve të lira; Matja e shfrytëzimit të kapacitetit; Parashikimet e ardhshme	Të dhënat e personelit të KLD-së; Dokumentet e planifikimit strategjik; raportimet e Shkollës së Magjistraturës	Verifikimi i të dhënave të stafit; Saktësia e llogaritjes së kapacitetit	Vlerësimi i mjaftueshmërisë së stafit; Matja e optimizimit të kapaciteteve
Vlerësimi Gjeografik	Harmonizimi territorial-administrativ; Vlerësimi i infrastrukturës së transportit	Matja e distancës së udhëtimit; Analiza e aksesueshmërisë; Vlerësimi i barrierave gjeografike	Llogaritja e distancës; Analiza e kostos së transportit; Vlerësimi i aksesueshmërisë sezonale; Vlerësimi i kompensimit të teknologjisë	Sistemet e informacionit gjeografik; Të dhënat e transportit; Vlerësimet e infrastrukturës	Verifikimi i matjes së distancës; Saktësia e llogaritjes së aksesueshmërisë	Vlerësimi i ndikimit të aksesit gjeografik; Vlerësimi i mjaftueshmërisë së infrastrukturës
Integrimi i Teknologjisë	Vendosja e shërbimit dixhital; Kërkesat për akses elektronik	Vlerësimi i zbatimit të SIMC-it; Aftësia e paraqitjes së padive në rrugë elektronike; Disponueshmëria e shërbimit online	Matja e vendosjes së sistemit; Shfrytëzimi i shërbimit dixhital; Aftësia e aksesit të qytetarëve; Normat e adoptimit të teknologjisë	Statistikat e vendosjes së IT-së; Të dhënat e përdorimit të sistemit; Disponueshmëria e shërbimit dixhital	Verifikimi i vendosjes së teknologjisë; Saktësia e të dhënave të shfrytëzimit	Vlerësimi i transformimit dixhital; Matja e përmirësimit të aksesit elektronik
Analiza e Kostos dhe Përfitimit	Kërkesat për efikasitetin e burimeve; Kërkesat për optimizimin e buxhetit	Analiza e kostos operative; Matja e kostos së ofrimit të shërbimeve; Efikasiteti i ndarjes së burimeve	Llogaritja e kostos për çështje; Analiza e shfrytëzimit të buxhetit; Matja e optimizimit të burimeve;	Të dhënat financiare; Të dhënat e ekzekutimit të buxhetit; Informacion mbi ndarjen e kostove; Statistikat e	Verifikimi i të dhënave financiare; Saktësia e llogaritjes së kostos; Validimi i analizës së buxhetit	Matja e efikasitetit të kostos; Vlerësimi i optimizimit të burimeve; Vlerësimi i ofrimit të vlerës

Metodologjia	Baza Ligjore	Qasja e Zbatimit	Teknikat e Matjes	Kërkesat për të Dhëna	Procedurat e Validimit	Rezultatet e Pritura
			Vlerësimi i vlerës së ofrimit të shërbimit	ofrimit të shërbimeve		
Mbledhja e të Dhënave	Kërkesat për të dhëna gjithëpërfshirëse; nevojat për validim me shumë burime	Raportet vjetore të KLGJ-së; Statistikat e Ministrisë së Drejtësisë; Përgjigjet e drejtpërdrejta të gjykatave; Dokumentacion financiar	Shfrytëzimi i burimit parësor; Verifikimi i burimit dytësor; Integrimi i përgjigjes direkte; Validimi i burimeve të kryqëzuara	Raportet statistikore; Dokumentet financiare; Përgjigjet e gjykatave; Të dhënat administrative	Verifikimi i besueshmëris ë së burimit; Kontrolli i përputhshmër isë së të dhënave; Procedurat e validimit të saktësisë	Sigurimi i cilësisë së të dhënave; Besueshmëria e informacionit; Vlefshmëria e analizës
Validimi dhe Sigurimi i Cilësisë	Kërkesat për saktësi analitike; Mandatet për konsistencë metodologjike	Verifikim i burimeve të ndryshme; Kontroll i konsistencës kohore; Standardizim i treguesve të performancës; Uniformitet i metodës së llogaritjes	Validimi statistikor; Verifikimi i analizës së trendit; Kontrollimi i konsistencës së treguesve; Standardizimi metodologjik	Burime të shumëfishta të dhënash; Seri kohore para dhe pas miratimit të hartës; Tregues të performancës; Metodologjitë e llogaritjes	Zbatimi i procedurës së validimit; Masat e kontrollit të cilësisë; Protokollet e verifikimit të saktësisë	Konfirmimi i besueshmërisë së të dhënave; Sigurimi i saktësisë analitike; Konsistenca metodologjike

Tabelë 3: Numri i stafit administrativ dhe gjyqtarëve në pesë gjykatat

Numri i stafit administrativ dhe i gjyqtarëve sipas Gjykatave:	2020	2021	2022	Mesatarja 2020-2022	2023	2024	Mesatarja 2023-2024	% ndryshim (Staf administrativ/ gjyqtar)	% ndryshim (Numri i gjyqtarëve)
Tiranë	175/40 = 4.38	163/51 = 3.20	151/61 = 2.48	3.35	179/44 = 4.07	188/55 = 3.42	3.75	+11.8%	+2.5%
Fier	29/12 = 2.42	35/9.9 = 3.54	34/7.8 = 4.36	3.44	43/11 = 3.91	45/17 = 2.65	3.28	-4.7%	+44.3%
Apeli Tiranë	141/41 = 3.44	156/33 = 4.73	158/35 = 4.51	4.23[36]	115/32 = 4.79	123/24 = 4.39	4.59[37]	+8.5%	-24.1%
Administrative Tiranë	88/27 = 3.26	71/26 = 2.73	72/22 = 3.27	3.09	69/18 = 3.83	62/13 = 4.77	4.30	+39.2%	-54.2%
Administrative Lushnjë	29/8 = 3.63	25/8 = 3.13	25/4.4 = 5.68	4.15	24/6 = 4.00	32/7 = 4.57	4.29	+3.4%	+8.3%

[36] 36 mesatarisht gjyqtare gjate 2020-2022.
[37] 28 mesatarisht gjyqtare gjate 2023-2024

Tabelë 4 : Mesataret e treguesve kryesore për periudhën 2020-2022

Te dhënat e integruara per Gjykatat para miratimit te hartes (2020-2022)	Pezull (Fillim)	Të ardhura të reja	Përfunduara	Backlog	NL	Koha e disponimit	Raste për gjyqtar	Të zgjidhura për gjyqtar
Total (Tirana + Kruja)	41,168/2 20584	107,228.6/2 53614.3	97,201.6/2 48600.8	51,195.3/2 25597.6	190.6/197.6/2[38] 95.3/98.8	238.6/138.3/2 119.3/69.15	1,448.6/2 724.3	1,165.2/2 582
Total (Fier + Lushnja)	1,614.2/2 807.1	8,636.9/2 4318.4	8,488.6/2 4244.3	1,753.2/2 876.6	193.9/200/2 96.95/100	196.3/98.3/2 98.15/49.15	1,362.6/2 681.3	1,190.9/2 595.4
Total (6 apelet)	22,962.9/6 3827.1	**15,046.7**/6 2507.7	10,582.5/6 1763.75	27,414.4/6 4569	449.2 /501.2/6 74.8 83.5	8,834.2/2,224.4/6 1472.3 370.7	5,377.5/6 896.2	1,892.1/6 315.35
Total 4 administrative (Tirana + Korçë + Shkodër + Durrës)	4,489.8/4 1122.45	**12,054.6**/4 3013.65	11,552.9/4 2888.2	5,157.6/4 1286.4	387.2/4 96.8	1,078.5/4 269.5	3,116.2/4 779	1,968.5/4 492.1
Total 2 administrative (Gjirokastër + Vlorë)	955.9/2 477.95	**3,110**.3/2 1555.15	2,826/2 1413	1,242.3/2 621.15	184.6/2 92.3	304.6/2 152.3	1,554.2/6 777.1	1,103.3/2 551.6

[38] Te ndara respektivisht te dyja vlerat për rastet civile dhe penale

Tabela 5: Të dhënat e mesatares për secilin tregues për vitet 2023-2024

Gjykata	Pezull (Start)	Të ardhura	Përfunduara	Stok	NL	KD	Raste /gjyqtar	Të zgjidhura/gjyqtar
Gjykatat e rretheve - Mesatarja 2023-2024								
Tirana	**19,429**	**32,706**	**95295**	**50681**	**94.9/97.35**[39]	**269.5/76**	**928.95**	**633.95**
Fier	**1,968.5**	**7,364.5**	**9298**	**6282**	**89.6/103.4**	**276.5/35.5**	**763.25**	**566.75**
Gjykata e Apelit - Mesatarja 2023-2024								
Tirana	**28866**	**14197**	**6528**	**36,535**	**53.1%/75%**	**2787/854**	**1,924.65**	**356.35**
Gjykatat administrative – Mesatarja 2023-2024								
Tirana	**6,449**	**12,361**	**16870.3**	**6,830**	**97.05**	**208**	**1,257.95**	**803.35**
Lushnja	**1,621**	**2,541.5**	**3188**	**1,762**	**94.4**	**269.5**	**672.6**	**396**

[39] Reflekton vlerat të ndara për rastet civile dhe penale

Tabelë 6: Të dhënat statistikore të integruara për të dyja periudhat e analizuara

Periudha	2020-2022[40]					2023-2024				
Treguesit e eficiencës	Backlog	NL	KD	Raste/ gjyqtar	Të zgjidhura/ gjyqtar	Stok	NL	KD	Raste/ gjyqtar	Të zgjidhura/ gjyqtar
Rethit JP Tiranë	25597.6	95.3/98.8	119.3/69.15	724.3	582	50681	94.9/97.35[41]	269.5/76	928.95	633.95
Rethit JP Fier	876.6	96.95/100	98.15/49.15	681.3	595.4	6282	89.6/103.4	276.5/35.5	763.25	566.75
Apeli JP Tiranë	4569	74.8/83.5	1472.3/370.7	896.2	315.35	36,535	53.1%/75%	2787/854	1,924.65	356.35
Administrative Tiranë	1286.4	96.8	269.5	779	492.1	6,830	97.05	208	1,257.95	803.35
Administrative Lushnjë	621.15	92.3	152.3	777.1	551.6	1,762	94.4	269.5	672.6	396

[40] Vlerat e mesatares sipas kombinimit të të dhënave për gjykatat respektivisht para shkrirjes së gjykatave.
[41] Reflekton vlerat të ndara për rastet civile dhe penale